

**VENDIM**  
**Nr.722, datë 19.11.1998**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË URBANISTIKËS**

**(shfuqizuar)**

**I azhurnuar me:**

- VKM Nr.401, date 25.06.2004
- VKM Nr.545, date 12.08.2004
- VKM Nr.1503, date 19.11.2008
- VKM Nr. 574, date 14.07.2010

Ne mbështetje te nenit 5 te ligjit nr.8405, date 17.9.1998 "Për urbanistiken", me propozimin e Ministrisë se Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI :**

1. Miratimin e rregullorese se urbanistikes, qe i bashkëlidhet këtij vendimi.
  2. Vendimi i Këshillit te Ministrave nr.593, date 13.12.1993 "Për miratimin e rregullorese se urbanistikes "shfuqizohet.
- Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYEMINISTRI  
Pandeli Majko

**RREGULLORE URBANISTIKES**

**LLOJET, PERMBAJTJA DHE PROCEDURAT E HARTIMIT TE STUDIMEVE  
URBANISTIKE**

**A. Emërtimi dhe territori që përfshin studimi urbanistik**

1. Master plani: Është studim urbanistik me një temë të caktuar dhe përfshin të gjithë territorin kombëtar ose pjesë të veçanta të tij .
2. Studimi urbanistik rajonal dhe mjedisor: Është studim urbanistik kompleks dhe përfshin territorin e një ose më shumë rretheve.
3. Plani rregullues i përgjithshëm. Është studim urbanistik kompleks për një territor të kufizuar dhe përfshin territorin e një qyteti, së bashku me zonën suburbane (periferike) tejshtirjes perspektive, të një fshati, të një qendre të banuar, të një zone pushimi, të një territori industrial etj .
4. Studimi urbanistik pjesor: Është studim urbanistik i detajuar, që bazohet në parashikimet e planit rregullues të përgjithshëm dhe përfshin zona ose pjesë të territorit të tij, në të cilat parashikohen ndërhyrje rregulluese.
5. Planimetria e sheshit të ndërtimit: Është material grafik që nxirret nga studimi urbanistik pjesor dhe i bashkëngjitet vendimit për miratimin e sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij .

#### **B. Përmbajtja dhe mënyra e hartimit të studimeve urbanistike**

6. Master plani ka për qëllim krijimin e bazave për zhvillimin urbanistik dhe territorial të territorit për të cilin hartohet (p.sh. krijimin e bazave për zhvillimin e vendbanimeve, infrastrukturës, turizmit, industrisë etj) .
7. Master plani hartohet nga organet e specializuara për këtë qëllim.
8. Master plani që hartohet për gjithë territorin kombëtar porositet nga Këshilli i Ministrave. Në rastet kur master plani hartohet për një pjesë të territorit kombëtar dhe përfshin disa rrethe, porositet nga Këshilli i Ministrave me propozim të Këshillave të Rretheve që merren në studim dhe kur përfshin në një rreth porositet nga Këshilli i Rrethit që studiohet.
9. Master plani kryhet mbi bazën e detyrës së projektimit.
10. Detyra e projektimit hartohet nga investitori (porositësi), në bashkëpunim me institucionet e specializuara.
11. Detyra e projektimit duhet të përmbajë:
  - te dhënat mbi pozitën gjeografike dhe kufijtë e shtrirjes së territorit kombëtar që merret në studim në harta në shkallë 1 : 50 000 -1: 10 000;
  - te dhënat gjeografike me përshkrim dhe me planimetri në harta në shkallë 1: 50 000 - 1:10000 ;

-te dhëna sizmologjike, te mbështetura ne hartën e rajonizimit sizmik ne shkalle 1 : 50000;

-te dhënat klimatike dhe hidrologjike me përshkrim dhe me vizatime ne forme grafikesh te elementeve klimatike dhe skema te hartave ne shkalle 1 : 10000 -1 : 50000;

-te dhënat hidrologjike me përshkrim dhe planimetri ne harta ne shkalle 1 : 50000- 1 : 10000; -te dhëna hidroteknike me përshkrim dhe me planimetri ne harte ne shkalle 1:50000-1: 10000 -te dhëna morfologjike dhe gjeomorfologjie me planimetri dhe harta ne shkallen 1:50 000 - 1: 10000;

-te dhëna pedologjike me planimetri dhe harta ne shkalle 1 : 50 000 -1 : 10 000;

-te dhëna mbi komunitetet bimore, shtazore dhe ekosistemet e zonës se përfshirë nga studimi, -elementet qe parashikon normativa shtetërore ne drejtim te vlerësimit te ndikimit e jedis VNM);

-studime mbi mbrojtjen e mjedisit;

-te dhëna mbi shfrytëzimin e tokës me përshkrim dhe harta;

-te dhëna arkeologjike dhe historike, zonat muze ne mbrojtje dhe zonat nen mbikëqyrje,

-te dhënat mbi infrastrukturën e rrjeteve inxhinierie te rrugëve, ujësjellësve, elektrikut, kanalizimeve dhe telefonisë me planimetri ne harta ne shkalle 1 : 50000 -1 : 10000;

-studime urbanistike mbi qendrat e banuara me përshkrim dhe planimetri;

-te dhëna demografike mbi qendrat e banuara;

-studime ekonomike;

-te dhëna qe lidhen me temën e caktuar te studimit;

**12.** Master plani hartohet për një periudhe kohore mbi 20 vjeçare.

**13.** Përpara miratimit te master planit merret miratimi i organeve te pushtetit lokal, territoret e rretheve te te cilave preken nga këto studime.

**14.** Studimi urbanistik rajonal dhe mjedisor është studim kompleks qe ruan dhe mbron vlerat natyrore, mjedisore e paisazhistike dhe siguron vazhdueshmërinë e zhvillimit te qyteteve, fshatrave, qendrave te banuara dhe qendrave te prodhimit industrial, bujqësor, etj. ne territoret e rretheve për te cilat hartohet.

**15.** Studimi urbanistik rajonal dhe mjedisor përmban:

a) objektivat qe do te udhëheqin politiken territoriale te zonave urbane, rurale, industriale, bujqësore e te shërbimeve ne kuadrin e përgjithshëm te rregullave brenda territorit te rajonit;

b) zgjedhjen e modelit territorial duke përcaktuar udhëzimet dhe kriteret metodologjike për përcaktimin e zonave socio-ekonomike, te cilat krijojnë sektorë funksionale dhe do ti nënshtrohen planifikimit te planeve me te detajuara;

c) përcaktimin e problemeve kryesore për secilën nga zonat e sipërpërmendura dhe për problemet e caktuara, mënyrën e koordinimit me territoret jashtë rajonit;

- d) marrjen parasysh te zonave me karakter historik dhe veçori te spikatura ambientale dhe peisazhistike, duke specifikuar territoret qe do te trajtohen nga planet lokale, si parqe natyrore, zona te mbrojtura etj ;
- e) normat kryesore për hartimin e programeve te mbrojtjes dhe përdorimit te tokave, sistemeve hidrogjeologjike, hidrologjike, pyjore, te burimeve bujqësore, energjetike, te karrierave etj;
- f) elementet qe parashikon normativa shtetërore ne drejtim te vlerësimit te ndikimit ne mjedis (VNM);
- g) lokalizimin e veprave publike dhe infrastrukturave lokale, rajonale, kombëtare, baze për shërbime te interesit rajonal si rrugët e komunikacionit tokësor, ujqor, ajror, rrjetat e furnizimit me uje, me energji elektrike, te telefonisë, te kanalizimit, vendet e hedhjes se mbeturinave, fushat e depozitimit, si dhe zonat me destinacion te veçante;
- h) specifikimi i prioriteteve ne kuadrin rajonal dhe lokal, sipas sektorëve dhe objektivave te vendosura ne programin e zhvillimit;
- i) koordinimin me parashikimet e programit ekonomik -financiar;

**16.** Porositësi është Këshilli i Ministrave, për rastin kur studimi prek disa rrethe dhe Këshilli i Rrethit për rastin kur përfshin një rreth.

**17.** Studimi urbanistik rajonal dhe mjedisor hartohet mbi bazën e detyrës se projektimit. Detyra e projektimit hartohet nga porositësi (investitori) ne bashkëpunimin me institucionet e specializuara. Detyra e projektimit duhet te përmbaje:

-te dhëna mbi pozitën gjeografike dhe kufijtë e shtrirjes se rajonit qe merret me studim ne harta ne shkalle 1 : 50 000 -1 : 10 000;

-te dhënat inxhiniero-gjeologjike dhe topografike te hedhura ne harte ne shkallen 1 : 50000-1:10000;

**-të dhënat sizmologjike ne shkallen 1 : 500000 deri 1 : 100000;**

-të dhënat klimatike për rajonin dhe rrjeti i stacioneve nga merren këto te dhëna (temperatura, erërat, reshjet, lagështia etj);

-te dhënat hidrogjeologjike me përshkrim dhe planimetri ne harta ne shkalle 1: 50 000 -1:10000,

-te dhënat hidroteknike me përshkrim dhe me planimetri ne harte ne shkalle 1 :50000 -1 10000

-te dhënat morfologjike dhe geomorfologjie me planimetri dhe harta ne shkalle 1 : 50 000-1:10000;

-te dhënat pedologjike me planimetri dhe harta;

-te dhënat mbi komunitete bimore, shtazore dhe ekosistemet e zonës se përfshirë nga studimi; -elementet qe parashikon normativa shtetërore ne drejtim te vlerësimit te ndikimit ne mjedis(VNM);

-studime mjedisore;

-te dhëna mbi shfrytëzimin e tokës me përshkrim dhe harta;

-te dhëna mbi historinë e zhvillimit ekonomik-shoqëror te rajonit mbi zonat muze ne mbrojtje dhe zonat nen mbikëqyrje;

- te dhënat mbi ekonominë pyjore, parqet kombëtare, parqet periferike te qyteteve dhe zonat e pushimit te përbashkëta te banoreve te qyteteve e te fshatrave;
- te dhëna mbi zhvillimin demografik;
- te dhënat mbi zhvillimin faktik dhe ne perspektive te qyteteve, fshatrave dhe qendrave te banuara te rajonit;
- te dhëna mbi vëllimin e investimeve dhe ndërtimeve faktike e ne perspektive për çdo qytet, fshat apo qendër te banuar brenda territorit te rajonit;
- te dhëna mbi zhvillimin faktik e ne perspektive te industrisë;
- te dhëna mbi zhvillimin faktik e ne perspektive te bujqësisë e blegtorisë;
- te dhënat mbi infrastrukturën e rrjeteve inxhinierie, te rrugëve, ujësjellësve, elektrikut, kanalizimeve e telefonisë me planimetri dhe harta;
- te dhëna mbi vëllimin faktik te transportit dhe perspektiven.

#### **18. Studimi urbanistik rajonal dhe mjedisor për karakterin kompleks qe ka përbehet nga:**

- detyra e projektimit;
  - relacioni i përgjithshëm;
  - harta e gjendjes ekzistuese te rajonit ne shkallen 1 : 25 000 -1 : 5000;
  - plani rajonal i qendrave dhe zonave te prodhimit industrial.
- Ne këtë harte përcaktohen: vendet e ndërtimit dhe territoret e qendrave dhe zonave ekzistuese dhe te reja industriale, territoret mineral mbajtëse ose naftëmbajtëse ekzistuese ose te reja, ndërtimet e ndryshme qe shërbejnë për ruajtjen e ambientit nga dëmtesit industriale qe veprojnë ne ajër, toke dhe ujë.
- plani rajonal i zonave te prodhimit bujqësor. Ne këtë plan përcaktohen territoret e kulturave bujqësore si arat, pemishtet, vreshtat, ullishtat, pyjet, kullotat, parqet kombëtare etj ., vendndërtime te rezervuarëve dhe liqeneve qe do te shërbejnë për ujitjen, territoret e ndërtimeve bujqësore.
  - plani rajonal i qyteteve, fshatrave e qendrave te banuara;
- Ne këtë plan përcaktohen territoret e zhvillimit te qyteteve, te fshatrave dhe qendrave te banuar a ekzistuese, territoret e qyteteve, fshatrave e qendrave te banuara te reja, territoret e qendrave te pushimit, te plazheve, te qendrave turistike dhe qendrave shëndetësore;
- plani rajonal i sistemit te komunikacionit dhe te rrjetit rrugor. Ne këtë plan përcaktohen rrugët automobilistike, hekurudhore, ajrore dhe ujore qe lidhin qytetet, fshatrat dhe qendrat e banuara me qendrat e prodhimit industrial e bujqësor. Ne këtë plan mund te përfshihet edhe rrjeti i kolektorëve kryesore te furnizimit me ujë, i kanalizimit, i largimit te ujërave te industrisë, i linjave te tensionit te larte, i telefonisë etj.
  - plani i territoreve me vlera mjedisore. Ne këtë plan përcaktohen sistemet e mbrojtura, sistemet ekologjike, parqet kombëtare dhe lokale, rezervatet e florës e te faunës dhe klasifikimi i tyre sipas kriterëve për ruajtjen e mbrojtjen sipas dispozitave te veçanta.
- Plani rregullues i përgjithshëm, si rregull, hartohet pas hartimit te studimit urbanistik rajonal. Ai zgjidh ne tërësi problemet ndërtimore, ekonomike, higjeno-sanitare, inxhiniero-teknike te një qyteti, fshati apo qendre te banuar, parashikon zhvillimin urbanistik te qytetit, fshatit apo qendrës se banuar për një periudhe kohe te caktuar 10-

15 vjeçare, duke përcaktuar përparësitë e fazës së parë 5-vjeçare, përcakton kufijtë gjeografike të zhvillimit territorial të qytetit, fshatit ose të qendrës së banuar, si dhe periferisë së tyre.

**20.** Për të kursyer fondin e tokës e për të disiplinuar ndërtimet në planin rregullues të përgjithshëm paraqitet vija kufizuese e ndërtimeve me fazat e saj për zhvillimin perspektiv të qytetit, fshatit apo qendrës së banuar. Kufiri gjeografik i shtrirjes territoriale quhet vije kufizuese e ndërtimeve.

**21.** Për të shfrytëzuar sa më drejt dhe sa më mire territorin jashtë vijës kufizuese të ndërtimeve të qytetit dhe për të ruajtur të parapërgatitur territorin e zhvillimit perspektiv të tij përcaktohet zona suburbane me kufirin e saj. Zona suburbane përfshin një territor të caktuar gjatë perimetrit të qytetit ku ndodhen fshatra dhe qendra të banuara të tjera, të destinuar për zhvillimin e mëtejshëm të qytetit për një perspektivë shumëvjeçare. Madhësia dhe gjerësia e kësaj zone përcaktohet në varësi të kushteve të relievit, të mjedisit natyror e panoramik, **te dhënave gjeologjiko-inxhinierike e sizmike**, të faktorëve e kërkesave të tjera të veçanta. Kufiri gjeografik i shtrirjes territoriale të periferisë së qytetit për periudhën shumëvjeçare quhet vije suburbane.

**22.** Vendimet në fushën e urbanistikës që marrin komuna ose komunat fqinje, në territorin e zonës suburbane, duhet të respektojnë rigorozisht studimin urbanistik që behet për këtë zonë në kuadrin e planit rregullues të përgjithshëm.

**23.** Zona suburbane është territor i komunës ose komunave dhe në të ardhmen mund të jete pjesërisht ose tërësisht territor i bashkisë, prandaj organet e pushtetit lokal duhet të harmonizojnë vendimet për përdorimin e tokës, duke respektuar reciprocisht autonominë e tyre.

**24.** Plani rregullues i përgjithshëm hartohet i plote ose rishikohet.

**25.** Plani rregullues i përgjithshëm hartohet i plote në rastet kur:  
a -është marrë vendimi nga Këshilli i Ministrave për të ngritur një qytet, fshat apo qendër të banuar të re;

b -lindin kushte të reja ekonomiko-shoqërore që kërkojnë territore, hapësira dhe infrastrukturën baze primare të qyteteve, fshatrave apo qendrave të banuara ekzistuese dhe kur paraprakisht këto territore e hapësira janë në masën mbi 25 % të sipërfaqes ekzistuese të qytetit, fshatit apo qendrës së banuar;

c -kërkohen ose lindin probleme të rëndësishme dhe transformime teknike në sistemin e infrastrukturës, sidomos të rrjetit rrugor;

d -ezaurohen parashikimet e planit rregullues të përgjithshëm para afatit të parashikuar.

**26.** Plani rregullues i përgjithshëm rishikohet në rastet kur:

- a) shumë e të gjithë shtesave është me pak se 25 % e sipërfaqes brenda vijës kufizuese të ndërtimit ekzistues;
- b) krijohen kushte të reja ekonomiko-shoqërore që kërkojnë territore dhe hapësira për një nga zonat funksionale të qytetit ose fshatit;
- c) për efekt të interesit shoqëror kërkohen shpronësime të tokave prone e personave fizike e juridike dhe për pasoje duhet bërë ndryshimi i vijës kufizuese të ndërtimit.

**27.** Porositësi i planit rregullues të përgjithshëm është këshilli i bashkisë ose komunës.

**28.** Plani rregullues i përgjithshëm (PRRP) përmban:

a -objektivat dhe strategjinë, të ndara sipas zonave, që bashkia ose komuna synojnë të arrijnë nëpërmjet PRRP-se.

b -përcaktimet që influencojnë mbi pronësinë e tokës dhe vlerësimin e saj. Për këtë jep:

-klasifikimin sipas funksioneve;

-përcaktimin e mënyrës së zbatimit nëpërmjet studimit urbanistik pjesor;

-intensitetin dhe tipologjinë e ndërtimit që do të rezultojnë nga transformimet e brendshme në baze të SUP;

c -klasifikimi në zona funksionale të territorit që përfshihet nga plani, duke u mbështetur në gjendjen ekzistuese, në përdorimet e mundshme, në ndësitë e banimit, në infrastrukturën inxhinierie e sociale, si dhe rregullat që duhen ndjekur brenda secilës prej tyre për të ndryshuar destinacionin e përdorimit; Këto zona përcaktohen në baze të destinacionit mbizotërues të përdorimit;

d -shqyrtimin e zonave që do t'i nënshtrohen ndërhyrjeve të rikonstruksionit urbanistik, si dhe përcaktimin e zonave për shtrirjen e qytetit, kushtëzimet urbanistike dhe elementet kryesore që duhet të mbahen parasysh në secilën prej tyre gjatë hartimit të SUP;

e -strukturën e përgjithshme organike të territorit nëpërmjet elementeve të përcaktuara të zhvillimit urban, veçanërisht nëpërmjet sistemit të përgjithshëm të komunikacionit rrugor, hekurudhor, etj. , të rrjetave të furnizimit me ujë, me energji elektrike, të kanalizimit dhe të impianteve përkatëse, të rrjeteve të komunikimit teknologjik, të hapësirave të lira të destinuara për park, gjelbërim publik e pajisje të tjera publike;

f -përcaktimin e ndërhyrjeve për vlerësimin dhe ruajtjen e burimeve ambientale, bujqësore, peisazhistike e historike, duke vendosur kushtëzimet për përdorimin e tyre, si dhe të elementeve që parashikon normat shtetërore në drejtim të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM);

g- studimin e situatës gjeologjike, hidrologjike dhe sizmike të territorit për të vlerësuar pajtueshmërinë e parashikimeve të planit me to;

h- parashikime dhe drejtimet kryesore të vendosura prej master planit dhe studimit urbanistik rajonal, në mënyrë që të koordinojnë parashikimet e tyre me përshkrimet e PRRP-se;

i- vlerësimin ekonomiko-financiar të operacioneve që propozon PRRP-ja;

j- kufizime në lidhje me ndërtimet për:

-territore apo zona me ndërtime që paraqesin interes ambiental, peisazhistik, historik e kulturor;

- mbrojtjen e funksionit te infrastrukturave dhe impianteve me interes publik;
- mbrojtjen nga situata te mundshme rreziku për te garantuar pacenueshmërinë e njerëzve apo objekteve;
- k- përcaktimin e rrethanave, qe do te kërkojnë rishikimin e PRRP-se, ne funksion te popullsisë dhe indeksit te rritjes se saj, funksioneve dhe intensitetit te shfrytëzimit te truallit, si dhe te elementeve qe kane ndikuar ne klasifikimin fillestar te territoreve te përfshira nga PRRP ne zona funksionale;
- l- territoret dhe afatet për hartimin dhe miratimin e SUP, nëpërmjet te cilave do te zbatohet PRRP.

**29. Plani rregullues i përgjithshëm hartohet mbi bazën e detyrës se projektimit.**

Detyra e projektimit duhet te përmbaje:

- te dhëna për pozitën gjeografike dhe kufijtë e shtrirjes te territorit te qytetit, fshatit ose qendrës se banuar ne harta ne shkalle 1 : 5000 -1 : 2000 ;
- te dhëna gjeologjike me përshkrim dhe planimetri ne harta ne shkalle 1 : 5000 -1: 2000;
- te dhëna sizmologjike me përshkrim dhe me planimetri ne harte ne shkalle 1: 10000 deri 1: 5000;
- te dhëna klimatike dhe hidrogjike me përshkrim dhe me vizatime ne forme grafikesh te elementeve klimatike dhe skema te hartave ne shkalle 1 : 5 000 -1 : 2 000;
- te dhëna hidrogjeologjike me përshkrim dhe me planimetri ne harta ne shkalle 1 : 5000 - 1 : 2000;
- te dhëna mbi komunitetet bimore, shtazore dhe ekosistemet e zonës se përfshirë nga studimi.
- elementet qe parashikon normativa shtetërore ne drejtim te vlerësimit te ndikimit ne mjedis (VNM);
- studime mbi mbrojtjen e mjedisit;
- te dhëna arkeologjike dhe studime historike, zonat muze nen mbrojtje dhe zonat nen mbikëqyrje,
- te dhëna mbi infrastrukturën e rrjeteve inxhinierie te rrugëve, ujësjellësve, elektrikut, kanalizimeve dhe telefonisë me planimetri ne harta ne shkalle 1 : 5 000- 1 : 2000;
- te dhënat demografike;
- te dhënat mbi aktivitetin ekonomik faktik dhe ne perspektive;
- te dhënat për zonën e banimit mbi gjendjen faktike dhe ne perspektive;
- si dhe te dhëna te tjera qe lidhen direkt me studimin (p.sh kur studiohet plani rregullues i përgjithshëm i një qyteti apo qendre turistike duhen te dhëna për zonat e pushimit etj).

**30. Plani rregullues i përgjithshëm i qytetit, fshatit apo qendrës se banuar, ekzistuese hartohet ne dy faza:**

a- projektideja.

b- projekti teknik i rrjetit rrugor .

**31. Projekti i fazës se dyte behet pasi te jete miratuar projektideja nga organi sipas kompetencës dhe kur kërkohet nga porositësi .**



32. Plani rregullues i përgjithshëm i qytetit, fshatit apo qendrës së banuar të re hartohet në tri faza:

- a. studimi i përgjithshëm urbanistik për vendin e vendosjes së qytetit, fshatit apo qendrës së banuar të re;
- b. projektideja;
- c. projekti teknik i rrjetit rrugor .

33. Projektimi në fazën e dytë bëhet pasi të jetë miratuar studimi i përgjithshëm urbanistik.

34. Kalimi në fazën e tretë bëhet mbasi projektideja është miratuar nga organi sipas kompetencës dhe me kërkesë të porositësit.

35. Projektideja e planeve rregulluese të përgjithshme për qytetin duhet të përmbajë:

a. për qytetet ekzistuese :

- detyrën e projektimit;
- relacionin e përgjithshëm;
- hartën e rajonit në shkallën 1 : 50 000 -1 : 10 000, ku të jenë evidentuar qendra e rrethit, qytetet e tjera, fshatrat dhe qendrat e banuara të rrethit, infrastruktura inxhinierie dhe zonat e objekteve të veçanta;
- planimetrinë e gjendjes ekzistuese të ndërtimeve mbi dhe nën tokë, në momentin që hartohet plani rregullues i përgjithshëm;
- vijën kufizuese të ndërtimeve dhe vijën suburbane;
- skemën e rrjetit rrugor të qytetit;
- skemën e zonimit funksional të qytetit;
- skemën e fazave të rikonstruksionit të qytetit;
- skemën e infrastrukturës së qytetit, (ujësjellësit, kanalizimit, elektrikut, telefonisë);
- planimetrinë e terreneve të gjelbra, të pushimeve të terreneve sportive e të lojërave për fëmijë, të parqeve periferike të qytetit, të vendeve të pushimit turistik etj ;
- planimetri mbi fazat e zhvillimit të ndërtimeve të qytetit për të gjitha zonat;
- hartën gjeologo-inxhinierike dhe të dhënat e mikrozonimit sizmik të territorit ku shtrihet studimi i planit rregullues të përgjithshëm;
- planimetrinë e shpërndarjes së objekteve social-kulturore;
- studimi i qendrës së qytetit, zhvillimi panoramik i qytetit apo rrugëve kryesore të tij;
- sipas karakterit të qytetit e veçorive dalluese të tij mund të paraqiten edhe materiale të tjera studimore, me paraqitjet grafike përkatëse.

b. për qytetet e reja:

- detyrën e projektimit;
- relacionin e përgjithshëm;
- studimin rajonal me pozicionin e qytetit;
- planin e rajonit me rrjetin rrugor, qendrat e banuara dhe qytetet me të afërt;
- hartën e studimit pedologjik e të shfrytëzimit bujqësor për çdo vendvendosje;

-hartën gjeologo-inxhinierike dhe te dhënat e mikrozonimit sizmik për çdo vendvendosje.

**36.** Plan i rregullues i përgjithshëm i qytetit të ri për dy fazat e tjera në përmbajtje është i njëjti me ato të qytetit ekzistues .

**37.** Sipas karakterit të problemit urbanistik, faktorëve e kërkesave qytet formuese, veçorive dalluese të relievit, klimës etj., mund të paraqiten dhe materiale të tjera studimore të shoqëruara me paraqitjet grafike përkatëse.

**38.** Projektideja e planeve rregulluese të përgjithshëm për fshatin dhe për qendrën e banuar duhet të përmbajë:

-detyrën e projektimit;

-relacionin e përgjithshëm;

-planimetrinë e komunës, fshatrat dhe qendrat e tjera të banuara së bashku me infrastrukturën inxhinierike;

-planimetrinë e gjendjes ekzistuese të ndërtimeve mbi dhe nën tokë;

-planin rregullues të përgjithshëm të fshatit, vijën kufizuese të ndërtimeve;

-skemën e rrjetit rrugor të fshatit;

-skemën e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, elektrikut, telefonisë;

-planimetrinë në fazat e zhvillimit të ndërtimeve të fshatit për të gjitha zonat;

-sipas karakterit të fshatit e veçorive dalluese të tij, mund të paraqiten edhe materiale të tjera studimore me paraqitjet grafike përkatëse.

**39.** Projekti teknik i rrjetit rrugor hartohet mbi bazën e projektidese së rrjetit rrugor të planit rregullues të përgjithshëm. Projekti teknik i rrugëve hartohet në reliev në shkallë 1 : 500 dhe në qytetet me reliev të aksidentuar në shkallë 1 : 200.

**40.** Projekti teknik duhet të përmbajë:

-planimetrinë e rrugës gjatë gjithë gjatësisë së kërkuar, ku të jepen këto të dhëna teknike:  
a- koordinatat nga poligonet ose grafikisht nga objektet për akset dhe vertekstet e rrugëve,

b- kuotat e rrugëve;

c- pjerrësitë dhe distancat e rrugëve;

d- elementet kryesore të kthesave;

e- prerjet tërthorë të rrugës;

f- vijat e ndërtimit.

**41.** Projekti i zbatimit të planit rregullues të përgjithshëm hartohet i pjesshëm mbi bazën e kërkesës dhe detyrës së projektimit të bashkësive apo komunës dhe investimeve të planifikuara për këtë qëllim. Projekti i zbatimit të rrugëve hartohet mbi bazën e projektit teknik të rrugëve sipas kërkesës së investitorit.

Projekti i zbatimit të rrugëve hartohet në relieve në shkallë 1 : 500 dhe për qytete me relieve të aksidentuar në shkallë 1 : 200.

**42.** Projekti i zbatimit të rrugëve duhet të përmbajë:

-planimetri e rrugës gjatë gjithë gjatësisë së kërkuar ku jepen këto të dhëna teknike:

a- koordinatat nga poligonet ose grafikisht nga objektet për akset dhe vertekstet e rrugëve;

b- kuotat e rrugëve;

c- pjerrësitë dhe distancat e rrugëve;

d- elementet kryesore të kthesave dhe elementet e hollësishëm të kthesave;

e- prerjet tërthorë të rrugës;

f- vijat e ndërtimit;

g -hollësitë teknike të rrugëve;

h -piketat e rrugëve;

i -pusetat e çfarëdo lloji projekti inxhinierik;

j -izoipset e projektit të rrugës.

-Planin e prerjes gjatësore të rrugës, i cili përmban :

a -kuotat e tokës ;

b -kuotat e rrugës;

c -pjerrësitë e rrugës;

d -distancat pjesore dhe progresive të piketave;

e -elementet e hollësishëm të kurbave vertikale;

f- elementet kryesore të kthesave.

Shkalla me e përshtatshme është 1 : 100 1: 1000

-Planin e prerjeve tërthore të rrugës që përmbajnë:

a- profilin e tokës.

b- profilin e rrugës.

c- sipërfaqet gjërmim mbushje,

d- tabelat e volumeve.

Shkalla me e përshtatshme është 1: 100 ose 1: 100

1 : 100 ose 1 : 200

-Preventivin e rrugës

**43.** Studimi urbanistik pjesor zëbërthen me tej planin rregullues të përgjithshëm. Ai hartohet për një zonë funksionale të qytetit, një pjesë të saj, e deri për një shesh ndërtimi.

**44.** Studimi urbanistik pjesor përcakton qartë kondicionet urbanistike dhe kriteret e zgjidhjeve vëllimore dhe arkitektonike të ndërtimeve, duke respektuar treguesit kryesore që jep plani rregullues i përgjithshëm.

**45.** Nëpërmjet studimit urbanistik pjesor behet zbatimi i planit rregullues të përgjithshëm.

**46.** Studimi urbanistik pjesor (SUP) tregon kufijtë e zonës se përfshirë prej tij dhe përmban:

- a) nëndarjet parcelore, si edhe tipologjitë e ndryshme të ndërtimeve dhe vendosjen e tyre në lidhje me kufijtë e sheshit të ndërtimit;
- b) trasimin e rrjetit të komunikacionit brenda zonës dhe lidhjet me atë të zonës përreth sipas parashikimeve të PRRP, rrjetin rrugor me profilet dhe kuotat e tij, si dhe kondicionet kryesore të altimetrise;
- c) karakteristikat dhe trasimin e rrjetave të furnizimit me ujë, të kanalizimeve, të energjisë elektrike, të telefonisë, dhe të shërbimeve të tjera që parashikon plani;
- d) hapësirat për veprat me interes publik (shkolla, objekte tregtare, objekte kulti, parqe publike, objekte sportive, objekte publike, ndërtesa me karakter rekreativ e kulturor, objekte shëndetësore, etj.) me kushtëzimet urbanistike dhe arkitektonike për secilën prej tyre;
- e) koeficientet e shfrytëzimit të territorit dhe kushtëzime të tjera urbanistike si vëllimet, lartësitë, vijat e ndërtimeve dhe zonat mbrojtëse përgjatë rrugëve sipas përcaktimeve të PRRP-se;
- f) ndërtimet që parashikohen për t'u shembur, rikonstruktuar apo restauruar, sipas parashikimeve të studimit pjesor, të shoqëruara edhe me tipologjinë e tyre;
- g) përcaktimet për ndërtimet që do t'i nënshtrohen kushtëzimeve ose ndërhyrjeve të veçanta (objekte monumentale ose me interes të veçante ambiental, zona arkeologjike etj.);
- h) elementet që parashikon normativa shtetërore në drejtim të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM);
- i) listat sipas zërave kadastrorë të pronarëve për t'u shpronësuar ose që do t'iu vihen kushtëzime të caktuara;
- j) vlerësimin ekonomik -financiar për zbatimin e SUP .  
përmbajtja e SUP ndryshon në raport me veçoritë specifike të çdo zone.
- k) Normat teknike dhe rregullat për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin

**47.** Studimi urbanistik pjesor hartohet mbi bazën e detyrës së projektimit. Detyra e projektimit duhet të përmbajë:

-planimetrinë e zonës funksionale të planit rregullues të përgjithshëm ku mbështetet studim urbanistik pjesor (kur studimi urbanistik pjesor hartohet për një pjesë të saj) në shkallën 1: 5000 deri 1 : 1000;

-planimetrinë e zonës funksionale, për të cilën hartohet studimi urbanistik pjesor në shkallën 1 : 2000 deri 1 : 500;

**-te dhëna inxhiniero -gjeologjike, topografike dhe sizmologjike;**

-te dhëna demografike;

-azhurnimi i rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe ajror (ujësjellës, kanalizim, elektrik, telefonik etj.);

-te dhëna për monumentet me vlera historike, arkeologjike dhe ndërtimet e tjera karakteristike që ndodhen brenda studimit urbanistik pjesor;

-si dhe te dhëna te tjera te hollësishme sipas zonës funksionale qe do te studiohet.

**48.** Studimi urbanistik pjesor, hartohet me dy faza:

a) projekt ideja,

b) projekti i zbatimit.

a- Projektideja e studimit urbanistik pjesor duhet te përmbaje:

-detyrën e projektimit te hartuar e miratuar nga organi sipas kompetencës;

-relacionin e përgjithshëm, se bashku me kondicionet urbanistike;

-planimetrinë e zonës funksionale sipas planit rregullues te përgjithshëm ku te përcaktohet pjesa e saj ku do te kryhet studimi urbanistik pjesor ne shkallen 1: 5 000 deri 1 : 1 000;

-planimetrinë e zonës funksionale ne shkallen 1 : 2 000 deri 1 : 500, për te cilën hartohet studimi urbanistik;

-planin e zonimit funksional;

-skemën e rrjetit rrugor;

-projekt idenë e infrastrukturës;

-planimetrinë me fazat e ndërtimit;

-fazat e rikonstruksionit;

-planin e zonimit vertikal sipas lartësisë te kateve;

-pamjet arkitektonike dhe panoramike te ndërtimeve gjate rrugëve kryesore;

-maketin, perspektiven ose aksonimetrinë ajrore te zonës ku shtrihet studimi urbanistik pjesor;

-projektin teknik te rrjetit rrugor;

-pasqyrën e treguesve tekniko-ekonomike.

b- Projekti i zbatimit te studimit urbanistik pjesor përmban:

-planin e zonimit funksional ne shkallen 1 : 1 000;

-planin e piketimit dhe te kuotimit te objekteve ne shkallen 1 : 1 000 ose 1 : 500 dhe për zona me relief te aksidentuar ne shkallen 1 : 200;

-rrjeti rrugor ne shkalle 1 : 1 000 ose 1 : 500 dhe për zona me relief te aksidentuar ne shkallen 1: 200;

-planin e sistemeve ne shkallen 1 : 1000 ose 1 : 500 dhe per zona me relief te aksidentuar ne shkallen 1 : 200;

-projektin teknik te rrjetit inxhinierik ne shkallen 1 : 1000 ose 1 : 500;

-planimetrinë e kateve përdhe te te gjitha ndërtimeve (për zonën e banimit, planimetritë e katit tip te banesave te fazës se pare) ne shkallen 1 : 200;

-pamjet arkitektonike e panoramike te ndërtesave gjate rrugëve ne shkallen 1 : 200;

-projekti teknik i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit

**49.** Planimetria e sheshit te ndërtimit, bashke me kondicionet urbanistike, mbështetet ne studimin urbanistik pjesor dhe shoqërohet me vendimin e KRRT -se rrethit për dhënien e sheshit te ndërtimit qe i jepet kërkuesit, person fizik apo juridik, vendas apo i huaj, qe do te ndërtoje një strukture ndërtimore mbi e nëntokësore.

**50.** Kur personi fizik e juridik, vendas apo i huaj qe do te ndërtoje, ka një propozim konkret për vendin, se bashku me kërkesën për shesh ndërtimi qe i drejtohet seksionit te urbanistikes ne Këshillin e rrethit, zyrës se urbanistikes ne bashki ose zyrës se urbanistikes ne komune, sipas kompetencës do te paraqesë edhe planimetrinë e sheshit te ndërtimit bashke me kondicionet urbanistike, qe me porosinë e tij ia harton një organ projektues i licencuar. Seksioni i urbanistikes ne këshillin e Rrethit, zyra e urbanistikes ne bashki ose zyra e urbanistikes ne komune, sipas kompetencës, ruan te drejtën qe mbi këtë propozim te paraqesë mendimin e vet ne KRRT .

**51.** Kur personi fizik e juridik, vendas apo i buaj qe do te ndërtoje, nuk ka propozim konkret për vendin, paraqet vetëm kërkesën për shesh ndërtimi ne seksionin e urbanistikes ne Këshillin e Rrethit, ne zyrën e urbanistikes ne bashki ose zyrën e urbanistikes ne komune sipas kompetencës. Seksioni i urbanistikes ne rreth, zyra e urbanistikes ne bashki ose zyra e urbanistikes ne komune, sipas kompetencës, harton vete ose porosit ne ndonjë organ projektues te licencuar shtetëror ose privat planimetrinë e sheshit te ndërtimit bashke me kondicionet urbanistike qe mendon t'i japë kërkuarit dhe e paraqet për miratim ne KRRT -ne e rrethit.

**52.** Ne planimetrinë e sheshit te ndërtimit do te jepen qarte te gjitha kondicionet urbanistike te përcaktuara nga studimi urbanistik, si sipërfaqja e sheshit te ndërtimit, vija kufizuese e ndërtimit, koeficienti i shfrytëzimit te territorit, funksioni i objektit, numri i kateve dhe lartësia e objektit mbi e nen toke, pozicioni kadastral, distancat kundrejt fqinjëve e pronësisë, hyrjet, daljet, lidhja me rrugët, kondicione te veçanta (për objekte ose pozicione te veçanta ) etj. Planvendosja e objektit dhe te dhënat e tjera grafike do te punohen mbi gjendjen ekzistuese te situatës urbanistike.

**53.** Ne planimetrinë e sheshit te ndërtimit duhet te përcaktohen qarte te gjitha rrjetat inxhinierike qe furnizojnë objektin qe do te ndërtohet (kanalizim, ujësjellës, elektrik, telefoni, mkz etj .,) dhe miratimin e tyre nga ndërmarrjet përkatëse .

**54.** Planimetria e sheshit te ndërtimit, bashke me kondicionet urbanistike, hartohet sipas modeleve 1 deri 6, ne baze te formateve A4- A0 ose shumëfishave te tyre. Përmasat e këtyre formateve ne m.m janë si me poshtë:

A4: 210 x 297

A2 : 297 x 420

A2 : 420 x 594

A1 : 594 x 840

A0: 840 x 1181

**55.** Planimetritë e studimeve urbanistike hartohen sipas modeleve 7 deri ne 11, ne baze te formateve standarde ose shumëfishave te tyre.

56. Për rastet urgjente të eliminimit të avarive të rrjetit inxhinierik nëntokësor (në trotuare dhe rrugë) punimet kryhen me autorizim të lëshuar nga seksioni i urbanistikës ose zyra e urbanistikës, sipas kompetencave në mbështetje të planimetrisë përkatëse.

Në autorizim shënohet koha e kryerjes së riparimit dhe detyrimet e ndërmarrjes që kryhen në rrugë apo trotuare dhe kthimin e tyre në gjendjen e mëparshme. Në rast shkeljeje të këtyre përcaktimeve, vlejné sanksionet e parashikuara në ligjin " Për urbanistikën ".

## **MODELI NR.7: MENYRA E PARAQITJES GRAFIKE TE STUDIMEVE URBANISTIKE**

Formati i vizatimit sipas standardeve ose shumëfishit të tyre

EMERTIMI I STUDIMIT SIPAS PERCAKTIMEVE  
NË NENIN 9 TË LIGJIT "PËR URBANISTIKËN"

MIRATOHET

SHKALLA.....  
SIPAS KOMPETENCES  
KRYETARI I K.RR.T. TË RRETHIT  
OSE  
KRYETARI I K.RR.T. TË BASHKISË  
STUDIMI

SKEMA E VENDOSJES SË STUDIMIT

Shkalla 1 : 10 000 - 1 : 25 000

Vula e plote e organit projektues të licencuar shtetëror ose privat, ose personit fizik të licencuar që ka bërë studimin dhe përgatitur këtë dokument

## **MODELI NR.8: MENYRA E PARAQITJES GRAFIKE TE STUDIMEVE URBANISTIKE**

Formati i vizatimit sipas standardeve ose shumëfishit te tyre

EMERTIMI I STUDIMIT SIPAS PERCAKTIMEVE NE NENIN 20 TE LIGJIT "PER URBANISTIKEN" MIRATOHET

SHKALLA.....

SIPAS KOMPETENCES

KRYETARI I K.RR.T. TE RRETHIT

OSE

KRYETARI I K.RR.T. TE BASHKISE

STUDIMI

SKEMA E VENDOSJES SE STUDIMIT

Shkalla 1 : 10 000 - 1 : 25 000

Vula e plote e organit projektues te licencuar shtetëror ose privat, ose personit fizik te licensuar qe ka bere studimin dhe përgatitur këtë document.

## **MODELI NR.9: MENYRA E PARAQITJES GRAFIKE TE STUDIMEVE URBANISTIKE**

Formati i vizatimit sipas standardeve ose shumëfishit te tyre

EMERTIMI I STUDIMIT SIPAS PERCAKTIMEVE NE NENIN 20 TE LIGJIT "PER URBANISTIKEN" ]

MIRATOHET

SHKALLA.....

KRYETARI I K.RR.T. TE SHQIPERISE

KRYETARI I K.RR.T. TE BASHKISE

STUDIMI



## SKEMA E VENDOSJES SE STUDIMIT

Shkalla 1 : 10 000 - 1 : 25 000

Vula e plote e organit projektues te licencuar shtetëror ose privat, ose personit fizik te licencuar qe ka bere studimin dhe përgatitur këtë document

## **MODELI NR.10: MENYRA E PARAQITJES GRAFIKE TE STUDIMEVE URBANISTIKE**

Formati i vizatimit sipas standardeve ose shumëfishit te tyre

EMERTIMI I STUDIMIT SIPAS PERCAKTIMEVE NE NENIN 20 TE LIGJIT "PER URBANISTIKEN" MIRATOHET

SHKALLA.....

KRYETARI I K.RR.T. TE BASHKISE

STUDIMI

## SKEMA E VENDOSJES SE STUDIMIT

Shkalla 1 : 10 000 - 1 : 25 000

Vula e plote e organit projektues te licencuar shtetëror ose privat, ose personit fizik te licencuar qe ka bere studimin dhe përgatitur këtë document

**MODELI NR.11: MENYRA E PARAQITJES GRAFIKE TE STUDIMEVE URBANISTIKE**

Formati i vizatimit sipas standardeve ose shumëfishit te tyre

PLANIMETRIA E SHESHIT TE NDERTIMIT TE OBJEKTIT  
SHKALLA.....

INFRASTRUKTURA , NDERMARRJET E UJEMBLEDHESIT, KANALIZIMET ,  
ELEKTRIKUT, TELEKOMIT, INSPEKTORIATIT SANITAR SHTETEROR TE RRETHIT,  
AFJENCIA RAJONALE E MBROJTJES SE MJEDISIT, NDERMARRJA E MBROJTJES  
KUNDRA ZJARRIT

DREJTORI I NDERMARRJES PERKATESE

Shenime:~::~~::~~::~~::~~::~~::~~::~~::~~::~~::~~::~~::~~::~~::~~::~

Firma ,

Vula

SKEMA E VENDOSJES SE STUDIMIT

Shkalla 1 : 10 000 - 1 : 25 000

Vula e plote e organit projektues te licencuar shtetëror ose privat, ose personit fizik te licencuar qe ka bere studimin dhe përgatitur këtë dokument.

**NORMAT, RREGULLAT DHE KUSHTET E PROJEKTIT URBANISTIK**

57. Normat, rregullat dhe kushtet e projektimi urbanistik janë plotësimi teknik dhe praktik i domosdoshëm i studimeve urbanistike. Këto janë te detyrueshme për te gjithë

organizmat projektuese ne fushën e projekteve urbanistike, shtetërore ose private, vendase ose te huaja te pajisura me licence. Mbi bazën e tyre do te vlerësohen e miratohen projektet urbanistike nga organet përkatëse sipas kompetencës qe jep ligji "Për urbanistiken" .

**58.** Master planet, studimet urbanistike rajonale dhe mjedisore, planet rregulluese te përgjithshme hartohen duke u mbështetur ne eksperiencën botërore, si dhe ne kërkesat e porositësit, duke iu nënshtruar diskutimit dhe gjykimit te organeve qe janë te interesuara për to.

**59.** Normat, rregullat dhe kushtet e projektimit te planit rregullues te përgjithshëm ndryshojnë sipas llojit te qytetit, fshatit apo qendrës se banuar (p.sh. industrial, muze, malor, bregdetar etj.). Prandaj, për qytetet, fshatrat e qendrat e banuara behet klasifikimi :

- sipas lartësisë mbi nivelin e detit;
- sipas zonave klimatike;
- sipas numrit te banoreve;
- sipas funksionit (administrativ, industrial, muze, pushimi etj.)

A. Plani rregullues i përgjithshëm për qytetet.

**60.** Normat urbanistike janë ne vartësi te madhësisë te qyteteve. Qytetet klasifikohen sipas numrit te banoreve si me poshtë:

Grupi I deri 10000 Grupi II 10000 - 20000 Grupi III 20000 - 50000

Grupi IV deri 50000 - 100000 Grupi V 100000 - 200000 Grupi VI mbi 200000

Ne grupin e pare, për ato qytete qe janë qendra rrethi, normativat urbanistike për objektet social kulturore, arsimore, shëndetësore, terrene sportive etj. do te llogariten ne shkalle rrethi.

**61.** Ne hartimin e planit rregullues te përgjithshëm duhet te parashikohet një shpërndarje e drejte e zonave funksionale te qytetit si:

- zona e qendrës se qytetit;
- zona e spitaleve (qytetet e grupit III dhe IV ),
- zona e gjelbër e qytetit;
- zona e terreneve sportive;
- zona universitare ose e institucioneve shkencore (qytetet e grupit IV);
- zona e varrezave publike;
- zona industriale;
- zona e bazave grosiste tregtare;
- zona mbrojtëse sanitare dhe zona e fidanishteve;
- zona e transportit te jashtëm te qytetit (stacionet hekurudhore ujore e ajrore );
- zona e parkut zoologjik dhe botanik (për qytetet e grupit IV - VI);

- zona e pushimit;
- zona e plazhit (për qytetet pranë detit, liqenit dhe lumenjve);
- zona turistike;
- zona te veçanta (p.sh. ne qytete te ndryshme mund te këtë zona muze, zone ambasadash);
- ndërtime te përkohshme (pjesë përbërëse e zonave te ndryshme te qytetit);

**62.** Zonat funksionale te qytetit lidhen ndërmjet tyre nga rrjeti rrugor.

**63.** Rrugët ne qytete ndahen ne pese kategori:

- rrugët e kategorisë se pare me 6 korsi kalimi janë shëtitorët dhe rrugët kryesore te trafikut te shërbimit urban për qytete te mëdha;
- rrugët e kategorisë se dyte me 4 korsi kalimi janë rrugët me trafik te rende (unazat) te qyteteve te mëdha dhe rrugët kryesore te shërbimit urban;
- rrugët e kategorisë se trete me 3 korsi kalimi janë rrugët qe ndajnë lagjet e banimit me njëra tjetrën;
- rrugët e kategorisë se katërt me 2 korsi kalimi janë rrugët e brendshme te lagjes se banimit;
- rrugët e kategorisë se peste me 1 korsi kalimi janë rrugët e brendshme te blloqeve te banimit.

**64.** Kategoritë e rrugëve brenda zonave te banimit janë:

- a) rruge me një korsi kalimi dhe një brez parkimi;
  - b) rruge me një korsi kalimi dhe dy breza parkimi;
  - c) rruge me dy korsi kalimi dhe një brez parkimi;
  - d) rruge me dy korsi kalimi dhe dy breza parkimi;
- Vija e ndërtimit për këto rruge jepet me projekte te veçanta.

**65.** Gjerësia e trotuareve ne rrugët shëtitore te qyteteve jepet me projekt te veçante.

**66.** Distanca minimale e banesave ose objekteve nga bordura e rrugës, për rruge qyteti te jete:

- jo me pak se 5m për rruge me gjerësi deri 7m;
- jo me pak se 7,5m për rruge me gjerësi 7-15m;
- jo me pak se 10 m për rruge me gjerësi mbi 15m.

**67.** Ndalohet dalja ne rrugët e kategorisë se pare nga rrugët e kategorisë se katërt dhe te peste. Distanca minimale e daljeve ne rrugët e kategorisë se pare, te rrugëve te kategorisë se dyte dhe te trete duhet te jete 100 m, ndërsa ne rrugët e kategorisë se dyte 50 m. Ndalohet dalja e çdo rruge me afër se 50 m nga kryqëzimi.

**68.** Kryqëzimet e rrugëve te qyteteve bëhen:

- a- me disnivel për dy rruge te kategorisë se pare;

b- me disnivel për rruge te kategorisë së parë me rruge te kategorisë së dytë;  
c- për kategoritë e tjera kryqëzimi behet sipas ne dispozicion.

**69.** Zona e banimit, me qëllim që të sigurojë kushte jetese të shëndetshme për popullsinë, duhet të vendoset në territorin me klimë më të mirë të qytetit, në zgjedhjen e saj duhet të kihet parasysh:

- diellzimi;
- temperatura e ajrit;
- drejtimi dhe shpejtësia e erës;
- lagështia e ajrit;
- reshjet atmosferike.

Në këta tregues duhet të mëren mesataret mujore, stinore dhe ato vjetore.

**70.** Elementet përbërës të zonës së banimit janë:

- a- terrene banimi;
- b- terrene shoqërore;
- c- terrene të gjelbra;
- d- terrene sportive;
- e- rruge, sheshe, vendqëndrime.

**71.** Në terrenet e banimit përfshihen njësitë urbanistike të banimit dhe rrugët e brendshme midis tyre. Pjesë përbërëse e tyre janë parcelat e çerdheve, kopshteve, shkollave 8-vjeçare dhe shërbimeve të përditshme tregtare e komunale.

Terrenet e banimit ndahen në njësi strukturore urbanistike. Mbështetur në përvojën e ndërtimit të qyteteve tona dhe në madhësitë territoriale dhe të popullsisë së tyre njësitë strukturore të terreneve të banimit janë:

- grup banimi;
- bllok banimi;
- kompleks banimi;
- lagje banimi.

**72.** Grupi i banimit është njësi me e vogël me popullsi deri në 1 000 banorë dhe me sipërfaqe deri në 1.5 ha për ndërtime shumë familjare dhe deri në 5 ha për ndërtime një familjare. (Për qytete të kategorisë III-IV dhe rikonstruksionet e qyteteve.) Grupi i banimit për ndërtesat shumë familjare përbehet:

- sipërfaqe ndërtimi 4.5 m<sup>2</sup>/banorë
  - sipërfaqe e lire 10 m<sup>2</sup>/banorë
  - territor banimi neto 14.5 m<sup>2</sup> /banorë
  - shesh lojërash për fëmijë 0-6 vjeç 1.3 m<sup>2</sup> /banorë
- Gjithsej 15.8 m<sup>2</sup>/banorë

73. Njësitë tregtare ose te shërbimit parashikohen ne katet përdhese te banesave. Ne treguesin 10m<sup>2</sup> /banore sipërfaqe e lire përfshihet norma 4m<sup>2</sup>/banore gjelbërim. Pjesa tjetër është sipërfaqe e pandërtuar dhe rruge deri ne hyrjet e banesave.

74. Blloku i banimit është njësia urbanistike qe përbëhet nga 3-4 grope banimi me popullsi 3000 - 4000 banore dhe sipërfaqe 6-8 ha për ndërtime shume familjare dhe deri 30 ha për ndërtime njefamiljare. Baza e organizimit te bllokut te banimit janë objektet shoqërore te kopshtit, çerdhes, njësite e shërbimit tregtar komunal, si dhe terrenet sportive për fëmije mbi 6 vjeç. Blloku i banimit për ndërtesat shume familjare përbëhet nga :

- territori i banimit neto 14.5 m<sup>2</sup>/banore
  - shesh lojërash për fëmije 1.5 m<sup>2</sup>/banore
  - sipërfaqe për objekte shoqërore 2.0 m<sup>2</sup>/banore
  - terrene sportive 0.5 m<sup>2</sup>/banore
  - rruge dhe sheshe midis grupeve 1.5 m<sup>2</sup>/banore
- Gjithsej 20.0 m<sup>2</sup>/banore

75. Kur shërbimet tregtare dhe komunale janë zgjidhur te veçanta, parcela e tyre llogaritet me treguesin 0.5 m<sup>2</sup>/banore dhe i shtohet normative se bllokut (20 m<sup>2</sup>/banore).

76. Ne ndërtimet njefamiljare, për sipërfaqet e objekteve shoqërore dhe te terreneve sportive, përdoret e njëjta normative. Treguesit e tjerë ndryshojnë ne funksion te zgjidhjes se madhësisë se parcelave.

77. Kompleksi i banimit është njësia urbanistike qe përbëhet nga disa blloqe banimi me popullsi 6000-8000 banore dhe sipërfaqe nga 16-20 ha për ndërtime shumefamiljare. Ne përbërje te kompleksit merr pjese shkolla 8-vjeçare. Kompleksi i banimi përbëhet:

- territor banimi neto 14.5 m<sup>2</sup>/banore
  - shesh lojërash për fëmije 1.5 m<sup>2</sup> /banore
  - sipërfaqe për objekte shoqërore 2.0 m<sup>2</sup> /banore
  - sipërfaqe për terrene sportive 1.5 m<sup>2</sup> /banore
  - gjelbërim i organizuar (lulishte) 1.5 m<sup>2</sup> /banore
  - sipërfaqe rruge dhe sheshe midis blloqeve 3.0 m<sup>2</sup> /banore
- Gjithsej 24.0 m<sup>2</sup> /banore

78. Për shërbimet tregtare e komunale te zgjidhura te veçanta, normativa për territorin e tyre është m<sup>2</sup>/banore dhe kjo i shtohet normative se kompleksit te banimit (24.0 m<sup>2</sup> /banore).

79. Ne treguesin normativ për objektet shoqërore janë llogaritur sipërfaqet e nevojshme për parcelat e çerdheve e kopshteve qe variojne nga 0.3-0.4 ha për një çerdhe ose një kopsht dhe për parcelën e shkollës 8-vjeçare 0.6-1 ha.

80. Te gjithë këto norma janë mbështetur ne studimin demografik, i cili ka përcaktuar

grupmoshat përkatëse që kanë nevojë funksionale kopshtin, çerdhen apo shkollën. Nga kjo rezulton që bllokut të banimit për popullsinë e tij i duhet një çerdhe dhe një kopsht dhe kompleksit të banimit dy çerdhe, dy kopshte dhe një shkollë 8-vjeçare. Për këto objekte shoqërore është dhënë treguesi m<sup>2</sup>/për banorë në grupimet e mësipërme të terreneve të banimit.

**81.** Lagje banimi është njësi urbanistike me e madhe që përbëhet nga dy komplekse banimi me popullsi 12-16 mijë banorë dhe sipërfaqe 32-40 ha. Ka në përbërje të saj shërbime të përqendruara tregtare, komunale të shërbimit social, kopsht, çerdhe, dy shkollë 8-vjeçare, një shkollë të mesme, parkun e lagjes, terrene sportive të të gjithë grup moshave, shërbimin shëndetësor dhe administrativ, salla koncertesh, biblioteke etj.

**82.** Kjo njësi urbanistike vlen për qytetet e kategorisë së IV -V-VI. Për këtë kategori qytetesh në çdo 2-3 lagje duhet të këtë dhe qytete të shkallës së qytetit.

**83.** Për qytetet e kategorisë I. II. III. ndarja bëhet me komplekse ose me blloqe banimi. Objektet shoqërore respektive të bllokut, kompleksit apo lagjes edhe kur këto njësi urbanistike nuk formojnë terrenet e banimit, në funksion të madhësisë së qytetit duhet të parashikohen për vetë funksionet e tyre të domosdoshme për jetën e banorëve (p.sh. shkollë e mesme, kinema, teatër etj.).

**84.** Rrugët e kategorisë së parë, të dytë dhe të tretë nuk duhet të përshkojnë grupin, bllokun kompleksin dhe lagjen e banimit.

**85.** Sipërfaqet e nevojshme për parkimet e hapura dhe të mbyllura janë :

- për banesa kolektive, 15m<sup>2</sup>/për parkim dhe në vend parkimi për familje;
- për zonat masive sportive, vend parkimi/5veta;
- për parqe brenda qytetit, vend parkimi 10/veta;
- për parqe periferike të qytetit, vend parkimi/15 veta;
- për objekte kulturi, vend parkimi / 4 veta,
- për biblioteka, vend parkimi 25/veta,
- për qendra tregtare, 1 vend parkimi 3/veta;
- për qendra shëndetësore, 1 vend parkimi/25veta,
- për qendra spitalore, 1 vend parkimi/4 shtretër ;
- për kinema, vend parkimi/4 vende ;
- për teatër, vend parkimi/5 vende ;
- për qendra qytetesh, 0.02 m<sup>2</sup> parkimi/banor zone;
- për objekte shoqërore, 0.10 m<sup>2</sup> parkimi/banor zone.

Shënim: banor zone është numri i banorëve të një zone që i shërben objekti i mësipërm.

**86.** Terrenet e banimit realizohen me ndërtesa shumëfamiljare ose me ndërtesa njëfamiljare. Si në zona të lira ndërmjet ndërtesave ekzistuese, ashtu dhe në territore të reja ato vendosen mbi bazën e një studimi urbanistik.

- 87.** Terrenet shoqërore përfshijnë parcelat e:
- ndërtesave administrative te lagjeve te qytetit;
  - ndërtesave kulturore te lagjeve te qytetit;
  - shkollave te mesme;
  - ndërtesave shëndetësore;
  - ndërtesave te shërbimit tregtar te lagjeve te qytetit;
  - ndërtesave te shërbimit komunal te lagjeve te qytetit;
  - monumenteve te kulturës.

- 88.** Terrenet e gjelbra përfshijnë sipërfaqet e:
- parqeve apo lulishteve te kompleksit te banimit, 1 - 2 m<sup>2</sup>/banore;
  - parqeve e lu lishteve te qytetit, 2 m<sup>2</sup>/banore;
  - gjelbërimit rrugor e brigjeve ujore, 1 m<sup>2</sup>/banore;
  - gjelbërimit ne objektet shoqërore, 2 m<sup>2</sup>/banore;

- 89.** Terrenet sportive, përfshijnë sipërfaqet e:
- terreneve sportive te lagjeve për grupmoshat III dhe IV, 1.6m<sup>2</sup>/banore;
  - objekteve te aktivitetit cilësor e spektakël (stadiume, pallate sporti, palestra, pishina etj.)

- 90.** Rrugët, sheshet, vendqëndrimet përfshijnë sipërfaqet e:

- rrugëve kryesore te qytetit, se bashku me trotuaret;
- rrugëve midis komplekseve;
- shesheve si hapësirave te lira;
- vendqëndrimeve te automjeteve, te hapura ose te mbyllura.

**91.** Normativat e projektimit urbanistik te zonës se banimit janë përmbledhur ne tabelat nr.1 deri nr.4.

Ne këto tabela jepen dendësia bruto e neto e banimit dhe koeficienti i intensitetit te ndërtimit neto "i"

- dendësia bruto e banimit është raporti midis numrit te banoreve me sipërfaqen e territorit bruto te njësisë urbanistike.

- dendësi neto e banimit është raporti midis numrit te banoreve me sipërfaqen e territorit te banimit neto.

- intensiteti i ndërtimit neto "i" është koeficienti qe tregon intensitetin e ndërtimit ne territorin e banimit. Ai shpreh raportin ndërmjet shumës se sipërfaqes se kateve te banimit mbi sipërfaqen e territorit te banimit.

## **Tabela 1**



Elementet përbërës të zonës së banimit

Qytetet sipas numrit të banoreve

Terrene banimi m<sup>2</sup>/b

Terrene shoqërore m<sup>2</sup>/b

Terrene të gjelbra m<sup>2</sup>/b

Terrene sportive m<sup>2</sup>/b

Rruge shesh m<sup>2</sup>/b

Gjithsej m<sup>2</sup>/b

Deri në

10 000 52-46 5 3-4 4 6-7 70-66

10 000 - 20 000 46-41 5-6 4-5 4-3 7-8 66-63

20 000 - 50 000 41-36 6-7 5-6 3-2 8-9 63-60

50 000 - 100 000 36-30 7 6-7 2 9 60-55

100 000 - 200 000 30-27 8 7 2-2.4 9-10 55

Mbi 200 000 26.5 12 7 2.5 12 60

## **Tabela 2**

Dendësia e popullsisë për blloqe të komplekse banimi

Numri i kateve të banesave

Dendësitë e banimit bruto e neto b/ha sipas sipërfaqes së lire 12 m<sup>2</sup>/banore

2 Bruto 100-170 Neto 140-220

3 Bruto 280-300 Neto 500-530

4 Bruto 300-350 Neto 540-600

5 Bruto 360-380 Neto 650- 750

6 Bruto 380-400 Neto 750- 780

8 Bruto 420-440 Neto 780-820

9 Bruto 440-460 Neto 850-900

### **Tabela 3**

Tabela e te dhënave për ndërtime individuale me lartësi kati 2 – 3

Emërtimi

Banesa ne rresht

Banesa te vendosura dy e nga dy

Banesa te veçanta

1. Sipërfaqja e parcelës ne m2 150-190 200-300 300-500

2. Dendësi bruto banore/ha 170 130 100

3. Dendësi neto banore/ha 220 170 140

4. Intensiteti i ndërtimit e sip.te kateve sip.pergj.e parcelave 1.3-0.8 0.85-0.5 0.8-0.3

### **Tabela 4**

Elementet përbërës te kompleksit te banimit dhe lagjes

Madhësia e njësisë urbanistike

Terr. Banimi Ha m2/b

Terr. Shoqërore Ha m2/b

Terr. Gjelbra	Ha	m2/b
Terr. Sportive	Ha	m2/b
Rruge-sheshe	Ha	m2/b
Gjithsej	Ha	m2/b

### Kompleksi

6000 – 8000

b 1. 12 2.5 3 5 1 2 2.1 16 25

8.4 14 1.5 2.5 3 5 1 1.6 3.5 16.8 28

2.4 4

### Lagje

12000 – 16000

b I. 12 3.6 3 6 5 2 1.6 6 I. 27

16.8 2 5 38.4 32 7.2 6

### Dendësia e popullsisë

B/Ha dhe intensiteti i ndërtimit neto sipas lartësisë së kateve (kompleks banimi)

Treguesit 2 kate 3 kate 4 kate 5 kate 6 kate 8 kate 9 kate tekniko- ekonomik

### Dendësia

140-220 500-530 540-600 650-720 730-760 780-820 850-900

### popullsisë

### Intensiteti

0.3-0.8 0.5-7 0.7-0.9 1-1.3 1.2-1.4 1. 3-1.6 1.6-1. 8 nder neto

**92.** Zonat e qendrës te qytetit përbëhen nga tërësia e objekteve shoqërore te karakterit te qytetit, si p.sh. bashki, objekte kulti, teatër, banke, hotel, qendër tregtare, qendër biznesi, qendër administrative etj., se bashku me territoret e domosdoshme te tyre (vendqëndrime, sheshe, gjelbërim funksional etj ). Sipas madhësisë dhe karakterit te qytetit kjo zone ka karakteristika dhe madhësi te ndryshme. Normativat për këtë zone janë një shumatore e normave te objekteve shoqërore dhe shesheve te tyre. Zona e qendrës se qytetit për vete funksionin e saj duhet te jete lehtësisht e arritshme si nga këmbësoret, dhe nga automjetet. Ne terrenin brenda saj ajo duhet te funksionojë vetëm për këmbësoret.

**93.** Zona e spitaleve përbëhet nga tërësia e objekteve shëndetësore me shtretër, si spital patologjik, pediatri, kirurgji, maternitet, etj. Prandaj normativat për këtë zone janë një shumator te normativave te objekteve shëndetësore përbërëse te saj. Madhësia e zonës se spitaleve është ne funksion te madhësisë se qytetit. Ne qytetet e kategorisë I, II, III; kjo zone duhet te jete një e vetme, ndërsa ne qytetet e kategorisë se IV, V, VI mund te këtë dy a me shume zona spitalesh. Territori i zonës se spitaleve zihet me ndërtime ne masën 15 % te tij dhe pjesa tjetër shërben për gjelbërimin , rruge dhe shërbime ekonomike.

**94.** Zona e spitaleve duhet te këtë lidhje te mire me qendrën dhe rrugët kryesore te qytetit. Vendoset pranë zonave te gjelbra (jo te pushimit masiv), larg varrezave, pularive, kryqëzimit te rrugëve te trafikut te rende, ne vende te mbrojtura nga erërat e forta, zhurmat, tymrat, pluhurat dhe ndotësit indus triale. Territori i zonës se spitaleve duhet te këtë jo me pak se dy hyrje. Morgu duhet te këtë hyrje dhe dalje te veçante.

**95.** Zona e gjelbër e qytetit përbëhet nga:

- Gjelbërimi i përgjithshëm shoqëror ku hyn ( sipas kategorisë se qytetit):

a- gjelbërimi i zonës se banimit;

b- gjelbërimi i zonës se pushimit.

- Gjelbërimi shoqëror i kufizuar (sipërfaqet e gjelbëruara te objekteve me funksion te ndryshëm p.sh. çerdhe, shkolla, konvikte, spitale dhe gjelbërimi përreth ndërtimeve një familjare).

- Gjelbërimi i veçante (kopshti botanik, zoologjik, gjelbërimi ne rezidenca, fidanishte, breza sanitare). Sipas karakteristikave te veçanta te qyteteve te ndryshme këto grupime te gjelbërimit here futen ne zonën e gjelbër te qytetit, here krijojnë zona te veçanta si zone pushimi, zone brezi sanitar dhe fidanishte, zone parku zoologjik e botanik etj.

**96.** Gjelbërimi i përgjithshëm shoqëror :

a. gjelbërimi i zonës se banimit

- gjelbërimi ne komplekse banimi 1.5 m<sup>2</sup> /banore

- gjelbërimi ne parqe e lulishte qyteti 1.5- 3.5 m<sup>2</sup>/ banore

- gjelbërim ne rruge, shëtitore, brigje ujore 2 m<sup>2</sup>/ banore

- Gjithsej 5 - 7 m<sup>2</sup>/ banore

Për parqet dhe lulishten, prone e personave, fizike e juridike, private nuk jepet normative urbanistike.

b. gjelbërim i zonës se pushimit

- park periferik 8-14m<sup>2</sup>/banore

**97.** Gjelbërimi shoqëror i kufizuar, 1-2 m<sup>2</sup>/banore përbëhet nga:

a- gjelbërim ne objekte me përdorim te kufizuar (gjelbërimi i zonës se spitaleve përdoret vetëm nga te sëmuret, gjelbërim i zonës universitare nga studentet etj);

b- gjelbërim ne shtëpitë njefamiljare.

**98.** Gjelbërimi i veçante

a- kopsht botanik 0.3 - 0.5 m<sup>2</sup>/banore

b- kopsht zoologjik 0.6 - 1 m<sup>2</sup>/banore

c- fidanishte, zone mbrojtëse sanitare 0.8 - 2 m<sup>2</sup>/banore

**99.** Zona e terreneve sportive përbëhet nga terrenet sportive qe klasifikohen ne:

a- terrene sportive te aktivitetit masiv;

b- terrene sportive te aktivitetit spektakël.

Ne terrene sportive te aktivitetit masiv hyjnë terrenet sportive dhe sheshet e lojërave për fëmije te grupuar ne katër grup mosha:

- grupi i pare 0-3 vjeç;

- grupi i dyte 3-6 vjeç;

- grupi i trete 6-16 vjeç;

- grupi i katërt 16 vjeç e lart.

**100.** Treguesi urbanistik për grupin e pare dhe te dyte është dhëne ne normativen e grupit, bllokut dhe kompleksit te banimit, 1.25 m<sup>2</sup>/banore.

**101.** Treguesi urbanistik për grupin e trete dhe te katërt është dhënë ne normativen 1.6m<sup>2</sup>/ banore për kompleksin dhe lagjen e banimit. Kjo normative shërben për qytetin, për aktivitetet masive sportive.

b- Treguesi urbanistik i terreneve sportive te aktivitetit spektakël është 1 m<sup>2</sup>/ banore për qytetet e kategorisë se IV, V, VI. Për qytetet e kategorisë I, II, III përdoren normal e objekteve te karakterit spektakël (stadium, pallat sporti, pishine, fusha sportive etj.) mbasi normativa e mësipërme nuk i përshtatet madhësisë se tyre.

**102.** Terrenet sportive vendosen ne toka te papërshtatshme për ndërtime me relief te rrafshet ose me pak pjerrësi. Duhet te jene te mbrojtura nga era, te diellzuara dhe pranë burimeve e pasqyrave ujore.

**103.** Zona universitare dhe e institucioneve shkencore përbëhet nga objektet arsimore profesionale dhe te arsimit te larte (qe nuk bëjnë pjese nder objektet e zonës se banimit),

si dhe institucionet kërkimore e shkencore te fushave te ndryshme. Me përjashtim te qyteteve te kategorisë se IV, V ,VI ku këto formojnë zone, ne qytetet e tjera janë pjese përbërëse e objekteve shoqërore te karakterit te qytetit, qe përbejnë zonën e qendrës se qytetit.

Madhësia e kësaj zone është ne funksion te numrit te këtyre objekteve dhe treguesve urbanistike te veçante për secilin prej tyre. Zona universitare, për fluksin e madh te lëvizjes qe ka, duhet te lidhet mire me rrjetin rrugor te trafikut urban dhe te trafikut te jashtëm.

**104.** Zona e varrezave publike është territori i i varrezave, madhësia e te cilit është ne varësi te madhësisë te qytetit. Sipërfaqja territorit te varrezave llogaritet me treguesin 1.5 m<sup>2</sup>/banore te gjalle. Ne këtë tregues është përfshirë edhe sipërfaqja e gjelbërimit dhe e rrugëve te brendshme te varrezave. Territori i zonës se varrezave duhet te jete jashtë zonës se banimit, dhe jo me afër se 300 m nga shtëpia e fundit e qytetit, fshatit apo qendrës se banuar.

**105.** Zona industriale përbëhet nga territoret e objekteve industriale (ne qytetet e kategorisë I, II, III, hyjnë dhe territoret e bazave grosiste tregtare). Madhësia e saj varet nga lloji qytetit (industrial, bujqësor -industrial etj.) Zona industriale duhet te lidhet me te gjitha rrugët e trafikut te rende dhe trafikut te jashtëm. Pozicioni i saj kundrejt zonës se banimit përcaktohet duke pasur parasysh trëndafilin e erërave për qytetin, si dhe distancat dhe brezat mbrojtës sanitarë për te evituar dëmshmerine nga ndotjet, zhurmat, derdhjet etj.

Rrjeti i infrastrukturës se zonës industriale duhet te jete i pavarur nga ai i zonave te tjera te qytetit.

**106.** Zona e bazave grosiste tregtare, përbëhet nga territoret e depove te te gjitha kategorive. Si zone e veçante gjendet ne qytetet e mëdhenj te kategorisë IV - V-VI. Sipërfaqja e kësaj zone si norme orientuese duhet te jete 2-5% e sipërfaqes se përgjithshme te qytetit. Kjo zone duhet te lidhet me rrjetin e trafikut te rende dhe transportin e jashtëm te qytetit.

**107.** Zona mbrojtëse sanitarë dhe zona e fidanishtes llogariten si zone e veçante kur nuk është futur ne zonën e gjelbër te veçante te qytetit.

Për zonën e fidanishtes norma e dhënë tek zona e gjelbërimit te veçante nga 08 - 2m<sup>2</sup>/banore ndahet ne :

a- sipërfaqe për fidanë drurësh dhe shkurresh dekorative, 0.6-1.5 m<sup>2</sup>/banore;  
b- sipërfaqe për sera dhe lule dekorative, 02 -05 m<sup>2</sup>/banore.

**108.** Madhësia e zonave mbrojtëse sanitarë është ne varësi te shkalles se ndotjes se objekteve industriale, relievit te vendit dhe trëndafilin te erërave.

Sipas gjerësisë, zonat mbrojtëse sanitarë klasifikohen ne pese grupe:

grupi i pare, me gjerësi te zonës mbrojtëse sanitarë jo me pak e 700 m;

grupi i dyte, me gjerësi te zonës mbrojtëse sanitarë jo me pak 500 m;

grupi i trete , me gjerësi te zonës mbrojtëse sanitare jo me pak se 300 m;  
grupi i katërt, me gjerësi te zonës mbrojtëse sanitare jo me pak se 100 m;  
grupi i peste, me gjerësi te zonës mbrojtëse sanitare jo me pak se 50 m.

**109.** Ministria Shëndetësisë dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit duhet te bëjnë kategorizimin e objekteve qe sipas shkalles se ndotjes kërkojnë breza mbrojtës sanitare sipas klasifikimit ne pese grupe.

**110.** Zona e transportit te jashtëm te qytetit përfshin stacionet hekurudhore te pasagjereve dhe te mallrave, agjencitë e autobusëve inter- urbane, portet ujore, aeroportet, rrugët nacionale, (autostradat). Si norme orientuese kjo zone zë një sipërfaqe qe lëviz nga 3-11 % te territorit te përgjithshëm te qytetit. Treguesit urbanistike te kësaj zone i takojnë një faze te mëtejshme te studimit qe duhet te kryhet ne bashkëpunim me Ministrinë e Transporteve. Pjesët përbërëse te kësaj zone duhet te lidhen ne mënyre te shpejte dhe komode me zonat funksionale te qytetit si bacili, pushim, industri etj., me ane te rrjetit te tyre rrugor.

**111.** Zona e parkut zoologjik dhe botanik është pjese përbërëse e gjelbërimit te veçante te qyteteve. Treguesit urbanistike për këtë zone janë dhënë me sipër ne zonën e gjelbërimit. Ne qytetet e kategorisë se V dhe te VI mund te përbejnë dhe zone te veçante. Duhet te vendoset ne zona me gjelbërim natyror te pasur ne terrene me kushte te favorshme higjieno - sanitare, me vlera panoramike dhe pranë sipërfaqeve ujore (natyrore dhe artificiale), sipas studimeve përkatëse për këtë problem. Duhet te lidhen ne mënyre komode dhe te shpejte me zonën e banimit nëpërmjet rrugëve te trafikut te lehte. Kjo zone nuk duhet te përshkohet nga rrugët e trafikut. Ne kufi te saj, sipas studimit urbanistik zgjidhen vendqëndrimet e automjeteve te trafikut te lehte dhe urban.

**112.** Zona e pushimit përbëhet nga territoret e pushimit masiv te banoreve. Ne qytete te ndryshme ka karakteristika te ndryshme qe lidhen me pozicionin gjeografik, me klimën, natyrën, etj. Mund te jete pjese e zonës te gjelbër te qytetit (dhënë me sipër dhe si tregues urbanistik), si parqe periferike, vende te ndryshme panoramike, pyje etj. Duhet te lidhet sa me mire me zonën e banimit dhe te pajiset me objekte te ndryshme te shërbimit publik, si objekte argëtuese, kulturore, sportive, me sheshe te ndryshme lojërash për fëmije e te rritur, objekte shërbimi tregtare, rruge këmbësore, shkallare etj.

**113.** Zona turistike përbëhet nga zona me vlera te mëdha natyrore, peisazhistike, kulturore sportive, shëndetësore pushimi etj.

a. Përkufizimi i zonave turistike.

Konsiderohen zona turistike ato qe përdoren nga vizitore për qëndrime te shkurtra ose ekskursionet një ose disaditore; për pushim (plazhe detare, parqe pyjore, qendra alpine, brigje liqenesh, rezervuarësh e lumenjsh etj); për aktivitete sportive (gara, ngjitje alpinistike, ski, golf, ekskursionet, gjueti, peshkim); për aktivitete kulturore (shfaqje, vizita ne qendra e monumente historike, njohje te bukurive natyrore); për aktivitete biznesi

(seminare, panaiere); për aktivitete shtetërore e politike (kongrese, konferenca); për shërbime shëndetësore (kura termale, qendra rehabilitimi).

b. Kriteret baze të projektimit të zonave turistike janë:

- Në lidhje me ruajtjen:

Ruajtja dhe mbrojtja e mjediseve të çmuara dhe karakteristike natyrore e historiko-kulturore kundrejt urbanizimit:

Ruajtja e territoreve të aktiviteteve bujqësore, blegtorale, pyjore, detare, të prodhimit.

- Në lidhje me urbanizimin:

Urbanizimi i qyteteve dhe fshatrave ekzistues, që ndodhen në zona turistike, kryhet në vazhdimësi të tyre ose me krijimin e fshatrave të vegjël të integruar në mënyrë harmonike me mjedisin;

Urbanizimi i bregdetit duhet të jetë i kufizuar vetëm për pajisje që lidhen drejtpërdrejt me të. Në një rrip me gjerësi 250-300m nga niveli më i lartë i sipërfaqes ujore nuk lejohen ndërtime, përveç rasteve të veçanta që përbejnë objekt justifikimi të qarte mbi bazën e motiveve urbanistike ekonomike ose detyrimeve topografike.

Ndërtimet nuk duhet të prekin brezat pyjor.

- Në lidhje me rrugët:

Në bregdet, rrugët e reja transit duhet të ndërtohen në largësi nga vija e bregut jo më pak se 2000 m. Rrugët e shërbimit si rregull nuk vendosen gjatë bregut.

Në zona panoramike e malore rrugët e reja nuk duhet të vendosen jashtë kufirit pyjor.

Rruge këmbësore duhet të bëjnë të mundur hyrjen e vizitoreve në vijën bregdetare dhe në territoret e zonave turistike.

c. Norma për projektimin e komplekseve turistike

Kategoria turistike e ulet dhe e mesme Kategoria turistike e lartë dhe ulet .

Dendësia turistike e komplekseve turistike 100 - 150 vizitor për ha

50-100 vizitor për ha

Sipërfaqja mesatare e plazhit (ranor, gurale dhe shkëmbore) Jo më pak se 6 m<sup>2</sup>/vizitor

Jo më pak se 10 m<sup>2</sup>/vizitor

Gjatësia e bregut të plazhit Jo më pak se 0.5 ml/vizitor Jo më pak se 0.7 ml/vizitor

Sipërfaqja e detit për vozitje 1 ha për anije me motor 0.5 ha për anije me vela Idem

d. Përbërja e zonave turistike

Kompleksi turistik përmban ndërtime :

- Banimi (hotele, apartamente vila, bungaloë, rulo, çadra etj.);

- ndërtime shërbimi (restorant, bar, disko, dyqane, zyra, ambiente lojërash etj.);

- sheshe lojërash e sportesh, rruge shërbimi e këmbësore;

- parqe e lulishte;

- parkime, etj.

- Territoret e pyjeve, të sipërfaqeve ranore, gurale e shkëmbore, të pasqyrave ujore, të pajisjeve të përbashkëta të zonës turistike, të rrugëve të jashtme, të parkimeve qendrore, të veprave të pastrimit etj. , nuk përfshihen në normën e dendësisë turistike.

**114.** Zona të veçanta nuk janë karakteristike për të gjithë qytetet. Si të tilla emërtohen territoret e karakterit unikal kombëtar dhe ndërkombëtar ku kryhet një veprimtari e një



grupi te veçante njerëzish, banore apo jo te qytetit, për shembull zone ambasadash, zone reparti ushtarak, zone panairesh ose territore qe kane rregullore te veçante te trajtimit te tyre si për shembull: zone muze, zone arkeologjike, zone fetare etj. Për karakterin e tyre specifik, treguesi urbanistik i tyre, nuk jepet ne këtë rregullore.

**115.** Objekt ose ndërtim do te quhet çdo mase qe formon vëllimin ose sipërfaqe ndërtimore, e cila krijon hije dhe ngrihet ne lartësi, përveç pemëve ose gjelbërimeve te larta.

**116.** Ne objekte përfshihen ndërtesa, mure, mure rrethuese, ndërtime te përkohshme, ndërtime transparente, reklama dhe qe qëndrojnë ne lartësi mbi 1.8 m. Për përcaktimin e distancave ndërmjet objekteve ose ndërtimeve merren ne konsiderate tre faktorë kryesore:

- Orientimi;
- gjendje e fqinjësisë;
- kërkesat higjeno sanitare;
- kërkesat për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

**117.** Ne orientimin merret kusht baze orientimi drejt jugut ne kufij deri ne 40 grade te tij, si dhe tre ore diell ne periudhën 22 mars-22 shtator.

**118.** Ne gjendjen e fqinjësisë mbahet parasysh krijimi i hapësirave te nevojshme funksionale ndërmjet ndërtimeve.

**119.** Ne kërkesat higjeno-sanitare përfshihen kërkesat për ndriçim, diellzim, ajrim.

**120.** Ne mbështetje te treguesve te mësipërm distancat ndërmjet objekteve duhet te jene:  
a- kur ndërtesat vendosen karshi njëra-tjetrës dhe kane një gjatësi deri 20 m distance, distancat duhet te jene:

- për ndërtesa 1 kat, jo me pak se 4 metër;
- për ndërtesa 2 kat, jo me pak se 6 metër;
- për ndërtesa 3 kat, jo me pak se 8 metër;
- për ndërtesa 4 kat, jo me pak se 10 metër;
- për ndërtesa 5 kat, jo me pak se 12 metër;
- për ndërtesa 6 kat, jo me pak se 14 metër;
- për ndërtesa 7 kat, jo me pak se 16 metër;
- për ndërtesa 8 kat, jo me pak se 18 metër;
- për ndërtesa 9 kat, jo me pak se 20 metër;
- për ndërtesa 10 kat, jo me pak se 24 metër;
- për ndërtesa 11 kat, jo me pak se 24 metër;
- për ndërtesa 12 kat, jo me pak se 26 metër.

b- Kur ndërtesat vendosen karshi njëra-tjetrës, kane dritare dhe gjatësi mbi 20 m, distancat duhet te jene:

Për ndërtesa 1 kat, jo me pak se 6 metër;

për ndërtesa 2 kat, jo me pak se 9 metër;

për ndërtesa 3 kat, jo me pak se 13.5 metër;

për ndërtesa 4 kat, jo me pak se 18 metër;

për ndërtesa 5 kat, jo me pak se 20 m;

për ndërtesa 6 kat, jo me pak se 22 m;

për ndërtesa 7 kat, jo me pak se 24 m;

për ndërtesa 8 kat, jo me pak se 26 m;

për ndërtesa 9 kat, jo me pak se 27 m;

për ndërtesa 10 kat, jo me pak se 28 m;

për ndërtesa 11 kat, jo me pak se 29 m;

për ndërtesa 12 kat, jo me pak se 30 m.

c- Për përcaktimin e distancave ndërmjet dy ndërtesave me numër te ndryshëm katesh, distancat përcaktohen me interpolim, d.m.th. te dy ndërtesat konsiderohen me numër te njëjtë katesh, qe është i barabarte me mesataren e shumës se numrit te kateve te tyre.

Shembull: ne rastin e përcaktimit te distancës midis dy ndërtesave me lartësi 4 kat dhe 8 kat me gjatësi deri 20 m distanca do te përcaktohet si vijon:  $4 + 8 = 12$   
 $12/2=6$

Për lartësi te ndërtesës 6 kate i referohemi tabelës se pare dhe gjejmë distancën jo me pak se 14 m.

d- Kur banesat shumëkatëshe vendosen përbri njëra-tjetrës dhe faqet ne brinje nuk kane dritare, ato mund te jene te larguara deri ne 1 m ose ne bashkim te plote, me kusht qe te merren masa te caktuara për mbrojtjen nga zjarri, duke lënë nënkalime me përmasa 4m gjerësi dhe 5 m lartësi.

Ne çdo rast, ndërtimet duhet te respektojnë kufirin e ndarjes se pronësisë dhe bashkimi i plote mund te behet vetëm mbi bazën e marrëveshjes se pronareve fqinje.

e- Distancat e ndërtesave te banimit nga çerdhet, kopshtet, shkollat dhe objektet shëndetësore duhet te jene jo me pak se 1.5 here e lartësisë se ndërtesës me te larte qe qëndron nga jugu, ndërsa ne drejtimet e tjera te horizontit zbatohen distancat e caktuara ne pikat a, b dhe c.

**121.** Dalja konsol e mbi 50% te faqes se ndërtesës do te quhet faqe ndërtimi dhe do te merret parasysh ne llogaritjen e distancës midis ndërtimeve.

**122.** Për ndërtimet gjate rrugëve, çdo dalje konsol do te quhet faqe ndërtimi dhe nuk duhet te kaloje jashtë vijës se ndërtimit.

**123.** Kur pjerrësia e çatise lejon mundësinë e shfrytëzimit te mbi 50%te sipërfaqes se

përgjithshme të objektit që mbulohet dhe kur ka dritare në çati, për efekt të llogaritjes së distancave ajo konsiderohet një kat. Kur shfrytëzimi i çatise është 30- 50 % dhe kur ka dritare në çati ajo konsiderohet si gjysme kati.

Kur pjerrësia e çatise është mbi 45 grade dhe nuk ka dritare, për efekt të llogaritjes së distancave konsiderohet si gjysme kati.

**124.** Kur lartësia e katit përdhe është mbi 5.0 m mbi kuotën e sistemuar, për efekt të llogaritjes së distancave lartësia e këtij kati konsiderohet si një kat e gjysme dhe kur është mbi 6.0 m konsiderohet si dy kate.

**125.** Largësitë ndërmjet ndërtesave të banimit me të larta se 12 kate përcaktohen sipas studimeve urbanistike dhe projekteve të tyre.

**126.** Pavarësisht nga respektimi i distancave të dhëna në piken 120, në çdo rast, duhet të kihet parasysh edhe respektimi i treguesve të shfrytëzimit të territorit për zonën e banimit.

**127.** Vleftat e koeficientit të shfrytëzimit të territorit "k" për objektet në:

- zonën e qendrës së qytetit 0.7 - 0.85

- zonën e spitaleve 0.6 - 0.75

-zonën industriale 0.5 - 0.7

-zonën e bazave grosiste tregtare 0.7 - 0.85

Koeficienti i shfrytëzimit të territorit është raporti midis sipërfaqes së ndërtimit dhe sipërfaqes së parcelës së objektit.

B. Plani rregullues i përgjithshëm për fshatrat dhe qendrat e banuara

**128.** Për planet rregullues të përgjithshëm të fshatrave dhe qendrave të banuara, kriteret dhe normal urbanistike për zonat e ndryshme të tyre do të merren në analogji me zonat e qytetit, duke reflektuar karakteristikat e veçanta të tyre.

**129.** Për zonën e banimit, përdoren treguesit urbanistike të zonës së banimit të qytetit me ndërtime njëfamiljare.

**130.** Rrugët në fshatra ndahen në tre kategori:

- rrugë kryesore me gjerësi të pjesës së shtruar 7.5 m

- rrugë të dyta me gjerësi të pjesës së shtruar 5 m

- rrugica për kalimin e këmbësoreve me gjerësi të pjesës së shtruar 3 m

**131.** Për qendrat e banuara, në varësi të madhësisë së tyre, të përdoren normativat e qyteteve të kategorisë së I dhe II.

**RRUGET JASHTË QENDRAVE TË BANUARA DHE NDERTIMET GJATE TYRE**

**132.** a) Sipas përcaktimit dhe klasifikimit të bërë në nenin 2 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë", në rrugët e kategorisë "A", autostrada, të kategorisë "B", rrugë interurbane kryesore dhe të kategorisë "C", rrugë interurbane dytësore, nuk lejohen hyrje - daljet, përveç atyre të përcaktuara në projektin e rrugës.

b) Ndalohet çdo lloj ndërtimi, me përjashtim të pikave të karburantit, në një distancë jo më të vogël se:

i) 30 metra, nga kufiri rrugor i rrugëve të kategorisë "A";

ii) 25 metra, nga kufiri rrugor i rrugëve të kategorive "B" dhe "C";

Pikat e karburantit vendosen në një distancë jo më të vogël se 10 m, nga kufiri rrugor i rrugëve të kategorive "A", "B" dhe "C".

Në këtë kuptim, "kufi rrugor" konsiderohet fundi i pronësisë rrugore, referuar titujve të pronësisë dhe/ ose brezave të shpronësimit sipas projektit të miratuar.

Në mungesë të tyre, kufiri formohet nga vija e jashtme e hendekut të sigurimit të kanalit, kur ai ekziston, ose përkatësisht nga vija e sipërme/ e poshtme e skarpatës, nëse rruga shtrihet në terren të pjerrët.

**133.** Qytetet, fshatrat e qendrat e banuara ekzistuese që ndodhen në buze të rrugës kombëtare duhet të kenë parasysh:

- të kufizojnë shtrirjen e tyre gjatë rrugës kombëtare;

- në perspektive, të përqendrojnë shtrirjen e tyre vetëm në njërin anë të rrugës kombëtare dhe normal me të;

- të ruhet trupi i rrugës kombëtare dhe perspektiva e zgjerimit të saj, të respektojnë rigorozisht vijën e kuqe të ndërtimeve;

- të ndërtojnë rrugët paralel me rrugën kombëtare, për të evituar lëvizjet e mjeteve të transportit të brendshëm të tyre;

- të përmirësojnë vazhdimisht trajtimin arkitektonik dhe sistemimin e objekteve gjatë rrugës kombëtare,

- të mirëmbajnë dhe përmirësojnë gjelbërimin gjatë rrugës kombëtare.

**134.** Kondicionet ur banistike për trasimin e autostradave, rrugëve kombëtare dhe hekurudhore

- Autostradat, rrugët kombëtare dhe hekurudhat të distancohen nga zonat prioritare turistike, arkeologjike, muze dhe ambientaliste.

- Autostrada, rrugët kombëtare ose hekurudha të kalojnë tangencialisht me zonat prioritare turistike, arkeologjike, muze dhe ambientaliste kontinentale.

- Autostradat, rrugët kombëtare apo hekurudhat e reja të lidhin të gjitha qendrat e rretheve në të cilat ato kalojnë.

- Autostradat, rrugët kombëtare ose hekurudhat të kalojnë tangencialisht me qytetet, fshatrat apo qendrat e banuara.

- Pika me e afërt e autostradës, rrugës kombëtare ose hekurudhës me qytetin, fshatin apo qendrën e banuar të kalojnë në kufirin e zonës surbane (në vijën suburbane), të përcaktuar nga studimi urbanistik rajonal e mjedisor.

- Territori i qyteteve, fshatrave e qendrave te banuara, për asnjë rast, nuk ndahet nga traseja e autostradës, rrugës kombëtare ose hekurudhës.
  - Ndalohet shfrytëzimi i brigjeve natyrore te lumenjve, përrenjve e elementeve te tjerë natyrore ujore për trasimin e autostradave, rrugëve kombëtare e hekurudhave.
  - Lejohet transversimi për lumenjtë e përrenjtë.
  - Nuk lejohet transversimi i liqeneve dhe rezervuarëve.
  - Traseja e autostradës, rrugës kombëtare apo hekurudhës nuk duhet te preke rrugët e sotme kombëtare.
  - Ne rastet kur teknikisht është e detyrueshme te preken, te sigurohet qarkullimi i pandërprerë ne rrugën ekzistuese.
  - Kryqëzimi i autostradave, rrugëve kombëtare, rrugëve rajonale dhe rrugëve lokale me hekurudhat realizohet me mbikalim.
- Drejtimi kryesor i lëvizjes ne këto kryqëzime përcaktohet nga fluksi i lëvizjes sipas perspektives Shumëvjeçare dhe kategoria e rrugëve.
- Trasimi i rrjetit rrugor duhet te siguroje kalimin e mjeteve nga njëra rruge tek tjetra, ne varësi te kategorive te tyre.

**135.** Ndërtimet ne rrugët urbane (brenda qytetit, fshatit apo qendrës se banuar) duhet te respektojnë vijën e ndërtimeve.

Për të gjitha ndërtimet përgjatë rrugëve urbane që ndërlidhin autostradat apo rrugët interurbane kryesore e dytësore (unazat e jashtme dhe/ose rrugët hyrëse në qendrat urbane), përpara miratimit të lejes së sheshit të ndërtimit, subjekti duhet të pajiset me formularin 1/1, të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", të ndryshuar, së bashku me projektin teknik për hyrje - daljen e autorizuar, i cili miratohet nga enti përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e autostradave dhe rrugëve interurbane kryesore e atyre dytësore

#### IV. Normativat e projektimit te rrjetit te ujësjellësit

**136.** Nivelet e projektimit te rrjetit te ujësjellësit.

- a. Për studimet urbanistike rajonale dhe mjedisore, studimi i rrjetit te ujësjellësit behet ne fazën e skeme idesë;
- b. Për planet rregulluese te përgjithshme, studimi i rrjetit te ujësjellësit behet ne fazën e skeme idesë.
- c. Për studime urbanistike pjesore, studimi i rrjetit te ujësjellësit behet ne fazën e projektit teknik.

**137.** Normat e përdorimit te ujit.

- a) Normat e përdorimit te ujit për qendrat e banuara.

Nr	Emërtimi	Njësia e matjes	Normativa
1	Për qytete deri 10 000 banore	litra/banore ne dite	200
2	Për qytete 10 001 - 50 000 banore		250
3	Për qytete mbi 50 000		300
4	Për fshatra		100-150

Shënim: 1 - Normat e paraqitura ne tabelën e mësipërme përfshijnë sasinë e nevojshme te ujit për një banore si për përdorim vetjak për nevoja jetësore, ashtu edhe për përdorim publik.

b) Normat e përdorimit te ujit për zonat turistike. Për zonat turistike, normat e përdorimit te ujit variojne nga 400 litra/shtrat/ dite deri 500 litrat shtrat/ dite, ne varësi te kategorisë se turizmit dhe te karakterit te zonës.

c) Normat e përdorimit te ujit për ujitjen e sipërfaqeve te gjelbëruara dhe lagjen e rrugëve dhe shesheve.

Nr Emërtimi Njësia e matjes Normativa për 1 m<sup>2</sup>

1	Për ujitjen e sipërfaqeve te gjelbëruara ne qytet	Litra/ dite	1,5
2	Për ujitjen e sipërfaqeve te mbjella me lule	Litra/ dite	1,5
3	Për larje rrugësh dhe sheshesh ne dite me kohe te nxehte	Litra/ dite	2
4	Për drurët e porsambjelle për 3 vitet e pare (me 8-10 ujitje ne vit)	Litra/ dite/ çdo dru	18-27

Shënim: Normativat për drurët e porsambjelle ne 3 vjetet e pare mund te përdoren edhe për fidanishtet e drurëve dhe shkurreve dekorative ne shpërngultore 6-8 vjet.

- Për drurët dhe shkurret ekzistuese ne sipërfaqe me 3-4 ujitje ne vit, merret 80-100 litra.
- Për drurët ne trotuaret e rrugëve e bulevardeve me 3-4 ujitje ne vit merret 150 litra ujë për çdo rrënje.
- Për qendrat e banuara nga 10 000 - 100 000 banore, koeficienti orar i jonjëtrajtshmërise merret 4, ndërsa për 100 000 - 200 000 banore merret 2.
- Për ujitjen e fushave te golfit merret norma 41/m<sup>2</sup> ne dite.

### 138. Kërkesat e ujit për mbrojtjen urbane.

Gjate punës për te kryer një studim apo planifikim urban duhen patur parasysh kërkesat e ujit për mbrojtjen urbane:

Hidrantët e jashtëm te zjarrit te vendosen gjate rrugës ne afërsi te kryqëzimit te saj ne largësi jo me shume se 200 m nga njeri-tjetri, jo me afër se 5 m nga muret e jashtme te

ndërtesave dhe jo me larg se 2 m nga bordura e rrugëve. Zgjatja e kohës së shuarjes së zjarrit në qendrën e banuar pranohet 3 - 6 ore. Rrjeti i jashtëm i furnizimit me ujë kontrollohet për rastin kundër zjarrit në kohën e konsumit maksimal të ujit në qendrën e banuar.

## V. ROLI DHE DETYRAT E ISP URBANISTIKE

**139.** Instituti i Studimeve dhe Projektive Urbanistike (ISPU) është organi i specializuar shtetëror në nivel kombëtar në fushën e planifikimit të territorit dhe studimeve e projekteve urbanistike në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. ISPU-ja është konsulent i KRRTRSH-se dhe hyn në opozitë për të gjitha studimet e rëndësishme territoriale dhe urbanistike që hartohen nga institucione dhe organe të ndryshme studimore e projektuese vendase dhe të huaja, kundërshtues nga i interesuari.

**140.** ISPU-ja ka këto detyra:

**A.** Në fushën e studimit dhe projektimit:

- planifikon territorin dhe përdorimin e tokës në Republikën e Shqipërisë;
- kryen studime, masterplane dhe studime rajonale për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
- kryen studime të infrastrukturës kombëtare dhe rajonale;
- studion dhe harton plane rregullues të përgjithshëm të qyteteve;
- bashkëpunon me organe dhe institucione të ndryshme studimore vendase dhe të huaja për të kryer studime të specializuara, si master plane, studime urbanistike rajonale, plane rregullues të përgjithshëm etj;
- bashkërendon e sintetizon interesat e veprimtarisë së institucioneve qendrore dhe organeve të pushtetit lokal, ndërmarrjeve, sektorëve, individëve, ndërmarrjeve të përbashkëta, firmave të huaja, në fushën e realizimit të investimeve dhe të përdorimit të tokës mbi bazën e akteve ligjore, gjatë hartimit të studimeve urbanistike;
- bashkërendon studimet e institucioneve të tjera të specializuara, si p.sh. studimet sismologjike, demografike, sociologjike, hidro-gjeologjike etj., të domosdoshme për studimet urbanistike të tij.
- trajton problemet e ruajtjes së ekuilibrit natyror, duke i bashkërenduar me interesat e shfrytëzimit dhe të vlerave të ndryshme, si ato ambientale, ekonomike, kulturore, shoqërore dhe trajton strategjinë e përgjithshme për to.

**B.** Në fushën e legjislacionit:

- kryen studime në fushën e legjislacionit të urbanistikës dhe harton aktet ligjore e nënligjore në bashkëpunim me organe dhe institucione të tjera të interesuara;
- propozon ndryshime të akteve ligjore dhe nënligjore pranë organeve qendrore të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv;

- studion dhe harton akte teknike, metodika, rregullore e akte te tjera normative, ne zberthim te akteve legislative dhe te studimeve konkrete te kryera ne ndihme te organizmave te urbanistikes te pushtetit lokal.

**141.** Rregullat dhe normat urbanistike dhe arkitektonike për personat me aftësi te kufizuar

### 1. 1 Principet baze

Rregullat dhe normat urbanistike për personat me aftësi te kufizuar PAK reflektojnë konceptin e projektimit pa barriera urbanistike duke arritur përshtatshmërinë e ndërtimeve dhe hapësirave publike për një integrim ne jetën shoqërore te kësaj kategorie njerëzish njëlloj si te tjerët. Referimi ndaj principeve baze gjate procesit te planifikimit do te siguroje një shkalle te larte përshtatjeje për PAK. Principet baze për përshtatshmërinë formulohen si me poshtë:

-te jete e mundur te arrihen te gjitha vendet, ndërtesat publike dhe ato te banimit;

-te jete e mundur te hyet ne te gjitha ndërtesat publike dhe ato te banimit;

-te jete e mundur te përdoren te gjitha facilitetet publike dhe rregullimet mjedisore.

Këto principe duhet te interpretohen për te realizuar kërkesat e përgjithshme, te cilat duhet te merren parasysh ne planifikimin dhe projektimin fizik si me poshtë:

- Mundësia e hyrjes- mjedisi ndërtimor duhet te projektohet për te dhënë mundësi hyrje për te gjithë njerëzit.

- Mundësia e arritjes - duhet te sigurohet ne mjedisin ndërtimor qe sa me shume vende dhe ndërtesa te jete e mundur, te arrihen nga çdokush.

- Mundësia e përdorimit- mjedisi ndërtimor duhet te projektohet qe te përdoret e te shijohet nga te gjithë njerëzit.

- Orientimi - mjedisi ndërtimor duhet te projektohet qe te jete e lehte te orientohesh dhe te gesh rrugën ne te.

- Siguria - mjedisi ndërtimor duhet te projektohet qe njerëzit mund te lëvizin pa pasur friken e kërcënimit te jetës apo shëndetit.

- Mundësia e punës - vendet e punës, zyrat dhe mjediset industriale se bashku duhet te projektohen për te lejuar pjesëmarrjen dhe kontributin e PAK.

Problemet e zakonshme qe hasen për PAK ne mjedisin ndërtimor janë:

- lëvizja përreth, hapësira ndërmjet ndërtesave;

- hyrja ne ndërtesa.

Këto kritere përbejnë një baze për projektimin e mjedisit ne një mënyrë te tille qe pengesat dhe barrierat te shmangen.

### 1.2 Kërkesat e projektimit

Rrugët për PAK ne mjedisin ndërtimor, urban duhet te projektohen për te mundësuar përdorimin e tyre gjate lëvizjes ne këtë mjedis. Ato duhet te jene te lehta për t'i gjetur, te



vazhdueshme, te lehta për t'i përdorur, te lira nga pengesa te paparashikuara me sipërfaqe te qëndrueshme dhe te dimensionuara përkatësisht.

Te paktën një hyrje ne çdo ndërtesë duhet te jete e lehte për t'u gjetur dhe e lehte për t'u përdorur nga çdo person qe ka vështirësi ne lëvizje dhe vështirësi ne shikim.

Rrugët për tek dyert duhet te dimensionohen për te lehtësuar përdorimin për një karrige me rrota ose ndihmës te tjerë për te lëvizur.

Shenjat e vendosura mire dhe te projektuara mire janë te një rëndësie te madhe, për njerëzit për te gjetur rrugën e tyre brenda e jashtë ndërtesave. Projekti dhe vendndodhja janë veçanërisht te rëndësishme për personat me shikim dhe dëgjim te dëmtuar, si dhe për fëmijët. Shenjat, simbolet e tekstet informative duhet te paraqiten te tilla qe te jene te lehta për t'i kuptuar e lexuar, te përdoren tekste braille.

Vendndodhja e shenjave te jashtme ne përgjithësi duhet te jete e tille qe ana e poshtme e simbolit te informacionit te jete min. 2.1 m mbi toke.

Tabelat ne hyrjen e një kompleksi godinash me një harte orientuese te kompleksit, është udhëzues mjaft ndihmues për te gjithë vizitorët. Shkronjehzimi ne shenja ose tabela instruksioni duhet i qarte me relief ose ne braille.

Te vendosen piktogramet, te cilat janë figura ndërkombëtare.

## **RREGULLAT**

11.1.1 Rrugët e praktikueshme për personat qe kane vështirësi lëvizjeje Mjedisi ndërtimor duhet qe për PAK për lëvizjet horizontale te lehtësojë përdorimin e karrigeve me rrota, si dhe lëvizshmërinë rreth e rrotull me ndihmën e aksesoreve te ndryshëm teknike.

Për sigurimin e lëvizjes horizontale duhet te aplikohet ndërtimi i rrugëve te praktikueshme dhe lidhja e tyre me një nga rrugët e qarkullimit kryesor. Rruga e praktikueshme për PAK është rruga qe përdoret zakonisht ose një nga rrugët e përdorshme. Ajo duhet te siguroje lidhjen me hyrjen kryesore ose me një nga hyrjet kryesore dhe një shërbim te rregullt transporti. Këto kërkesa formojnë princip et kryesore te arritshmerise pa dallime sociale.

Kriteret dimensionale te lidhura me kuptimin e përshtatshmërisë janë kompetence për te përcaktuar komfortin e përdoruesve.

Rregullat teknike janë përcaktuar mbi bazën e dimensioneve ne plan te lëna nga një karrige lëvizëse ne pozicione te ndryshme. Shih fig.1. Rrugët e praktikueshme duhet te shtrohen me materiale antirreshqitese, veshje me tulla, plloça, jo me hapësirë.

Gjerësitë e tyre duhet te përballojnë kryqëzimin e dy karrocave. Ne rastin e disniveleve përdoren rampat dhe ne rastin e një disnivele me te madh se norma rekomandohet vendosja e një parmaku.

Rrugët këmbësore, si dhe kalimet trotuar - rruge realizojnë vazhdimësinë e rrugëve te praktikueshme për te transversuar rrugën qe nga trotuari.

Rrugët këmbësore krijojnë një komoditet max, për PAK nga siguria që ata gjejnë gjatë lëvizjes.

Rrugët urbane me trotuar kërkojnë sistemimin e kalimeve perpendikulare me aksin e rrugës, konceptimin e panduseve, të cilët kërkojnë uljen e trotuarit në të gjithë gjerësinë e pandusit. Shtrimi i pandusit duhet të bëhet me materiale guri, çimento të realizuara me cilësi. Rekomandohet vendosja e elementeve të vegjël në formë kurriz peshku në planin e inklinuar, duke mos lënë shenja të puthitjes.

### II.1.2.Parkimet

Të gjitha parkimet e automjeteve të jashtme dhe të brendshme duhet të përmbajnë një ose shumë vende të parkimit të sistemuar për PAK dhe i rezervuar përdorimi i tyre.

Anash vendeve të parkimit të automjeteve të sistemuara duhet të ketë një rrip hyrjeje.

Një vend i parkimit quhet i sistemuar për PAK kur ai përmban anash vendit të parashikuar për automjete një rrip i lire nga të gjitha pengesat, i mbrojtur nga qarkullimi i makinave dhe i lidhur me një rrugë të praktikueshme në hyrje të objektit.

### II.1.3 Rrugicat e drejtimit për personat që kanë vështirësi shikimi.

Rrugicat e drejtimit formohen duke krijuar kontrast në reliev dhe ngjyre me sipërfaqen përreth.

Rrugicat e drejtimit luajnë dy funksione: orientimi-nga tingulli diktues i fërkimit të bastunit. Siguri në lëvizje- pasi mbi këtë rrugicë, ndalohet vendosja e çdo mobilimi urban. Materiali që përdoret- pllaka antirreshqitese të vendosura perpendikularisht me rrugicën. Në hapësirat publike vendosen stacione me këmbalecë që përmbajnë tekste në reliev ose në alfabetin e të verbërve braille.

Për personat që nuk shohin është e nevojshme të sinjalizohet kufiri midis trotuarit dhe rrugës. Ky kufizues i tokës duhet të ngulet mbi trotuar, mbi panduse ose mbi rampat.

### 11.1.4 Mobilimi urban

Mobilimi urban i gjendur në trotuar ose i varur në mur, duke kufizuar trotuarin, duhet të gjendet jashtë rrugës së praktikueshme dhe gabaritet e tij duhet të korrespondojnë në lartësinë me të madhe se ajo e këmbësorit.

Pengesat të gjendura në lartësinë më pak se 2 m përbejnë një rrezik për personat që nuk shohin ose shohin keq. Mbështetja e informacionit, të drejtuara këto në kokën e shtyllës, duhet të gjendet lart nga toka në mënyrë të tillë që të lexohet nga personat me karrige lëvizëse dhe nga fëmijët. Karakteret duhet të jenë të mëdha dhe kontraste për ata që nuk shohin mirë dhe informacionet kryesore do të duhet të jenë në reliev për të verbrit.

Në mjedisin urban vitrinat mbrojtëse, strehët e autobusëve, pemët të përshtatshme për t'u futur në rastin e një moti të keq, luajnë rolin mbrojtës për PAK.

Aparatet për tërheqjen e biletave, parametri duhet të vendosen jashtë rrugës së praktikueshme.

Mobilimi i konstruksioneve te vogla si kioska gazetash, kutia e letrave, kabinat telefonike duhet te përshtaten për një karrige lëvizëse. Numri i telefonit duhet te jete përkruar ne relief dhe ne tipin braille.

### **III. 1. NORMAT URBANISTIKE PER PERSONAT QE KANE VESHTIRESI NE LEVIZJE**

#### **III.1.1 Rrugët e praktikueshme**

### **RREGULLATORE NORMAT ARKITEKTONIKE PER PERSONAT ME AFTESI TE KUFIZUAR**

#### **1.1 Principet baze**

Rregullat dhe normat arkitektonike për personat me aftësi te kufizuar PAK reflektojnë konceptin e projektimit pa barriera arkitektonike, duke arritur përshtatshmërinë e ndërtimeve për një integrim te PAK-ve ne jetën shoqërore. Referimi ndaj principeve baze gjate procesit te projektimit do te siguroje një shkalle te larte përshtatshmërie për PAK. Principet baze formulohen si me poshtë:

- te jete e mundur te arrihen te gjitha ambientet e brendshme te një ndërtesë publike ose banimi;
- te jete e mundur te përdoren te gjitha fasilitetet e brendshme te ndërtesës.

Këto principe duhet te interpretohen për te realizuar kërkesat e përgjithshme, te cilat duhet te merren parasysh ne planifikimin dhe projektimin fizik si me poshtë:

- Mundësia e hyrjes-mjedisi ndërtimor duhet te projektohet për te dhënë mundësi hyrjeje për te gjithë njerëzit.
- Mundësia e arritjes- duhet te sigurohet ne projektimin e mjedisit ndërtimor, qe sa me shume vende ne ndërtesë te mund te arrihen nga çdo kush.
- Mundësia e përdorimit- mjedisi ndërtimor duhet te projektohet i tille qe te përdoret e te shijohet nga te gjithë njerëzit.
- Orientimi- mjedisi ndërtimor duhet te projektohet ne mënyrë te tille qe te jete e lehte te orientohesh e te gjesh rrugën ne te.

- Siguria-mjedisi ndërtimor duhet te projektohet qe te gjithë njerëzit te mund te lëvizin pa pasur friken e kërcënimit te jetës apo te shëndetit.
- Mundësia e edukimit-mjediset e shkollave publike apo private te projektohen ne mënyrë te tille qe te mundësojnë pjesëmarrjen e te gjithë nxënësve ne kontekste te integruara.
- Mundësia e punës-vendet e punës, zyrat dhe mjediset industriale se bashku duhet te projektohen për te lejuar pjesëmarrjen dhe kontributin e PAK.

## 1.2 Kërkesat e projektimit

Këto norma janë te domosdoshme, sepse pengesat janë te pranishme kudo.

Disnivelet ne sipërfaqe, bordurat e ndryshme, gjerësitë e dyerve dhe tualetet e papershtatura, mund te përbejnë barriera te pakapërcyeshme. Problemi është te merret parasysh se si një përdorues i një karrigeje me rrota do te lëvizte lirisht nga parkimi deri tek pjesa me e largët e një ndërtesë, pa pengese. Kjo nuk do te ishte e kushtueshme, nëse nevojat e personave me aftësi te kufizuar do te merreshin parasysh qe ne fazat e hershme te projektimit.

Nga projektimi i kujdesshëm për personat me aftësi te kufizuar do te përfitojnë te gjithë përdoruesit e ndërtesës.

Te gjitha ndërtesat, përveç kushteve për banim, edukim e punësim, duhet te sigurojnë përshtatshmëri për personat me aftësi te kufizuar.

## 1.3 Shenjat dhe informacioni

Ne ndërtesat, kryesisht publike, vendosen shenjat për te identifikuar:

- Hyrjet e përshtatura ne ndërtesa;
- Ashensorët e përshtatur;
- Tualetet e përshtatura;
- Vendet e rezervuara për aftësinë e kufizuar;
- Ofrimin e një shërbimi special ne ndërtesa.

## 1.4 Dimensioni

Duke pasur parasysh përdorimin e karrigeve me rrota nga PAK ne mjedisin ndërtimor duhet te parashikohen hapësira te nevojshme për manovrimin e tyre. Kjo hapësirë do te lejoje edhe përdorimin prej këtyre personave edhe te mjeteve te tjera ndihmese mekanike ose te një asistenti. Ne fig. 2 dhe 3 jepen dimensionet e karrigeve me rrota dhe hapësirat qe mund te arrihen për veprim nga vete personat qe shfrytëzojnë mjetet.

## II. NORMAT DHE HOLLESITE NDERTIMORE

Projektimi i ndërtimeve

Projektimi konsiston ne përshtatshmërinë mbi bazën:

- e përdorimit të elementeve të përshtatshmërisë (rampa, parmakë, korimano etj.);
- e përshtatjes së ambienteve (tualetëve, ambienteve të gatimit etj.).

## II.1 Parkimi

Kërkohet që të këtë hapësira të veçanta parkimi të rezervuar për personat që kufizohen në përdorimin e karrigeve me rrota dhe mjeteve të tjera ndihmëse, sa me afër çdo hyrje, distanca max.50 m, në mënyrë që përdoruesi të lëvizë pa vështirësi. Duhet të merren masa, në zonat e parkimeve të hapura për mbulimin e hapësirës së parkingut të rezervuar për PAK, për t'i mbrojtur nga dielli dhe shiu.

## II.2 Hyrjet

Për përdoruesit e karrigeve me rrota rëndësi të veçante ka përshtatshmëria e hyrjes kryesore të ndërtesës. Disniveleli i krijuar zakonisht nga kuota e sistemuar e tokës natyrale dhe kuotës së dyshemesë në hyrje të ndërtesës duhet të shmangët për t'u shfrytëzuar edhe nga PAK. Hyrja (ose të paktën njëra hyrje në ndërtesat me shumë hyrje) duhet të jetë e projektuar e shoqëruar, krahas shkalleve, edhe me një rampe të pjerrët me parmakë në të dy krahët. Duhet të shmangen pragjet e dyerve me të larta se 20 mm. Ngjyra e pragjeve duhet të jetë në kontrast me dyshemënë. Për të lehtësuar identifikimin e hyrjeve për personat me shikim të dëmtuar, dera ose korniza e derës duhet të lyhet me një ngjyrë në kontrast me murin rrethues.

## II.3 Rampat e pjerrëta – panduset

Rampat janë elemente të domosdoshme që shoqërojnë shkallet në hyrje të ndërtesave, si dhe në disnivelet brenda një kati.

Pjerrësia e rampave me e preferueshme është 1:20. Pjerrësia max. nuk duhet të kalojë

1:12. Vetëm në rikonstruksionet, ku shpesh herë zgjidhjet kushtëzohen nga hapësira e kufizuar, mund të pranohet një pjerrësi edhe prej 1: 8, bile edhe 1: 6 si një zgjidhje me e mirë sesa mungesa e rampit.

Panduset nuk duhet të kalojnë gjatësinë max. 6.0 m kur ka një pjerrësi 1:12. Kur ka rampa me të gjata ato duhet të shoqërohen me një shesh pushimi me gjatësi 1.3 m. Rampat e pjerrëta duhet të pajisen me buze me lartësi 50 mm në anët e lira.

## II.4 Shkallet

Shkallet shpesh janë i vetmi mjet për të lëvizur ndërmjet kateve. Pra është e rëndësishme që shkallet të projektohen në mënyrë të tillë që lejojnë përdorimin nga personat me aftësi të kufizuar. Numri maksimal i basamakëve të shkallës për një pale shkal le duhet të

kufizohet ne 12. Kur nevojiten shkalle me te gjata duhet te perdoret një shesh pushim me gjatësi 1500 mm.

Projektimi i basamakëve me buze dhe boshllëk duhet te shmanget me qellim qe te minimizohet risku i pengimit.

Sipërfaqet e basamakëve duhet te jene prej një materiali jo te rrëshqitshëm dhe tapetet duhet te jene te fiksuara mire.

Për te ndihmuar personin me shikim te dëmtuar, duhet te vendoset një kontrast ne ngjyre midis shesh pushimeve, fillimit dhe fundit te shkalleve. Për me tepër edhe pamja ballore e çdo basamaku duhet te jete me e spikatur.

## Parmakët mbështetës- korimanot

Për te ndihmuar njerëzit gjate lëvizjes, korimanot duhet te vendosen kudo.

Një korimano duhet te jete i lehte për t'u kapur dhe preferohet te këtë një prerje tërthorë me diametër afërsisht 40 mm.

Korimanot duhet te jene te fiksuar mire, fundi i tyre duhet te kthehet ne drejtim te mureve ne te dy skajet e shkalleve jo me pak se 300 mm dhe jo te dale jashtë ne hapësirë te lire.

Korimanot horizontale duhet te montohen ne lartësinë 900 mm mbi dysHEME për përdoruesit PAK te përkohshëm dhe 700 mm mbi dysHEME për përdoruesit e karrigeve me rrota.

## II.6 Ashensorët

Ashensorët janë shpesh e vetmja mënyrë për shume njerëz qe te arrijnë vete katet e ndryshme te një ndërtesë, përveç katit përdhe. Ky akses ka rëndësi te veçante për personat me aftësi te kufizuar dhe është i nevojshëm për PAK qe te punësohen.

Ashensorët duhet te vendosen, pranë hyrjes kryesore te ndërtesës dhe te jene te dukshëm. Pajisja e ashensorit, jo gropa, duhet te jete e mjaftueshme për përdoruesit e karrigeve me rrota, me përmasa minimale 1000 x 1300 mm dhe dyert jo me te ngushta se 800 mm. Përreth kabinës vendoset korimania me lartësi 800-900 mm. Shenjat dhe kontrollet e ashensorit duhet te vendosen ne mënyrë qe te jene te lehta për t'u përdorur. Ato duhet gjithashtu te jene te kompletuara edhe me shkrimin brail për te verbrit.

## II.7 Hollët

Hollët duhet te dimensionohen me hapësira te mjaftueshme për përdorim nga personat me aftësi te kufizuar.

Ne hyrjet e paraholleve te ndërtesave publike me një gjerësi 1800 mm kërkohet një gjatësi minimale 2300 mm. Ne këto ndërtesa preferohen dyer automatike dyshe.

## II.8 Dyert

Projekti i dyerve dhe i hapësirës që i shoqëron ato përcaktojnë nëse një dhomë është e përshtatur për përdoruesit e karrigeve me rrota dhe te tjerët me lëvizje të dëmtuar. Gjerësia e derës, për përdoruesit e karrigeve me rrota duhet të jete 900 mm, por jo me e vogël se 800 mm.

Pragjet duhet të shmangen kudo që te jete e mundur ose te jete një lartësi max. 20 mm. Një prag prej game do të ishte me i përshtatshëm.

Dorezat duhet të jene te lehta për t'i përdorur. Ato montohen afërsisht 800-900 mm mbi nivelin e dyshemesë. Një dere që mbyllet me ane te sustës duhet të pajiset me një doreze tërheqëse që kapet lehte nga PAK me gjatësi te paktën 300 mm.

Xhami ose dyert e xhamta duhet të shënohen me një shirit ose vize me ngjyre pak poshtë nivelit te shikimit.

## II. 9 Dritaret

Vendi dhe lartësia përkatëse e dritares janë te rëndësishme ne mënyrë që përdoruesit e karrigeve me rrota te mund te shikojnë përtej dhe te hapin dritaret. Dorezat te hapen dhe te mbyllen lehte. Dritaret duhet te vendosen ne mënyrë që te eliminojnë verbimin për personat me dëmtim te shikimit me te vogël se 800 mm.

Një prag prej game do të ishte me i përshtatshëm.

Dorezat duhet të jene te lehta për t'i përdorur. Ato montohen afërsisht 800-900 mm mbi nivelin e dyshemesë. Një dere që mbyllet me ane te sustës duhet të pajiset me një doreze tërheqëse që kapet lehte nga PAK me gjatësi te paktën 300 mm. Xhami ose dyert e xhamta duhet të shënohen me një shirit ose vize me ngjyre pak poshtë nivelit te shikimit.

## II. 9 Dritaret

Vendi dhe lartësia përkatëse e dritares janë te rëndësishme ne mënyrë që përdoruesit e karrigeve me rrota te mund te shikojnë përtej dhe te hapin dritaret. Dorezat te hapen dhe te mbyllen lehte. Dritaret duhet te vendosen ne mënyrë që te eliminojnë verbimin për personat me dëmtim te shikimit.

## II.10 Tualetet

Preferohen tualetet unisex. Kjo lejon te përdoren tualetet e përshtatura nga secili sex. Aty ku ka tualete publike duhet te këtë te paktën një tualet unisex.

Te gjitha pajisjet duhet te jene te mundshme për t'u përdorur nga personat meaftësi te kufizuar. Dyert kur hapen nga brenda duhet lënë një hapësirë e mjaftueshme 1100x700 për hapjen e derës. Te gjitha dyert duhet te jene te hapshme edhe nga jashtë ne rast urgjencash.

Kur është e mundur, preferohet te parashikohet nga njëra ane e ëc-se një hapësirë për një përdorues te karriges me rrota për te lehtësuar komandimin e lëvizjes se tij.

Gjithashtu kërkohet te vendoset parmak mbështetës i varur (i lëvizshëm) dhe mbështetës (korimano) horizontale.

## II.11 Ambientet e gatimit dhe te ngrënies

Hapësira nen sipërfaqen e përgatitjes për gatim duhet te jete e lire. Dimensionet e tryezës se punës duhet te jene 800x600 mm me një lartësi 750-850 mm mbi nivelin e dyshemesë, ne varësi te tipit te karriges me rrota qe përdoret. Një karrige me rrote kërkon një hapësirë te lire te paktën 750 mm te gjere te një tavoline buke dhe te paktën 500 mm te thelle nen te. Duhet te sigurohen edhe lehtësira për shmangien e djegies ne ambientet e gatimit.

## II.12 Pajisjet sanitare

Pajisjet sanitare preferohen te jene prej porcelani. Kur pajisjet për larjen e duarve janë inoks, duhet te izolohet pjesa nen sipërfaqe për te shmangur djegiet. Ndenjëset e ëc-se duhet te jene solide dhe te fiksuara mire. Kur depozita e ëc-se është e montuar ne hapësirën e një o xhaku, mbështetësja e mbrapse duhet te sigurohet pas ëc.

Varëset për mjetet ndihmese te lëvizjes (patericat e bastunët) duhet te parashikohen ne lartësinë nga 800 deri ne 1040 mm, e ngjashme me varëset e rrobave.

Një pasqyre dhe një raft janë te dëshirueshëm, gjithashtu edhe kutia mbajtëse e peshqirit prej letre ose edhe tharëset e duarve automatike, kur është e mundur.

## II.13 Banjat me dushe dhe me vaske

Kur lëvizja për tek stoli i lëvizshëm (i vendosur ne mur) tek ambienti i dushit është i kufizuar, atehere dimensionet e kabinës se dushit duhet te rriten deri ne 1600 mm ne drejtim nga dera tek muri përballë saj dhe 1400 mm ne drejtimin tjetër, për te mundësuar përdorimin e stolit te lëvizshëm te dushit. Perdja e lëvizshme duhet te zbresë deri ne nivelin e dyshemesë dhe te jete brenda kabinës se dushit.



Koka e dushit duhet te këtë mundësi fiksime ne lartësi te ndryshme, me mundësi lëvizjeje dhe tub fleksibel.

Vaskat duhet te kenë mishelator, me koke dushi te lëvizshme me tub fleksibel.

## II. 14 Kontrollat elektrike dhe sanitare

Vendndodhja dhe projekti i te gjithë çelësave dhe pajisjeve te kontrollit është veçanërisht I rëndësishëm për personat me lëvizshmëri dhe shikim te dëmtuar. Ato duhet te vendosen ne mënyrë te tille qe te arrihen dhe te përdoren lehtësisht nga PAK. Çelësat dhe pajisjet e kontrollit duhet te jene te mëdha. Ato duhet te plotësohen edhe me shkrimin brail për t'u përdorur nga personat me dëmtim te shikimit. Gjithashtu rekomandohet te përdoren tregues me zë, llamba alarmi fleksibele, alarme vibruese, portative etj.

## II.15 Auditorët, qendrat e fesë, ambientet e konferencave, stadiumet

Ne projektimet e tyre, dimensionet e pozicioneve te caktuara për përdoruesit e karrigeve me rrota ne këto hapësira nuk duhet te jene me pak se 900 x 1400 mm. Hapësirat duhet te jene te tilla qe te lejojnë përdoruesit e karrigeve me rrota te qëndrojnë se bashku me shoqëruesit.

## II.16 Kushtet e përshtatshmërisë për personat me dëmtime te ndjeshmërisë.

Për persona me dëmtim te dëgjimit - ne sallat me sipërfaqe me te madhe se 100 m<sup>2</sup> duhet te instalohen nyjet induktive ose sistem me rreze infra te kuqe. Këto duhet te jene edhe ne ambiente shërbimi kur personi me dëmtim te dëgjimit komunikon me personelin nëpërmjet sipërfaqeve te qelqit.

Llamba alarm lëshuese duhet te vendosen ne ambiente publike.

Alarme vibruese portative duhet te vendosen ne dhoma hotelesh.

Për persona me dëmtime dëgjimi dhe shikimi - Hapësirat e mirendricuara janë te rëndësishme për te lexuar buzët dhe për te ndihmuar personat me dëmtim te pjesshëm te shikimit.

Për personat me dëmtim te shikimit - Te përdoren kontrastet e ngjyrave, sipërfaqet e prekshme te ashpra, tregues me zë, te eliminohen barrierat e panevojshme.

## II.17 Sipërfaqet e dyshemeve dhe te mureve

Te brendshme dhe te jashtme

Te shmangen rrezatimet verbuese nga sipërfaqet e tavanëve, mureve e dyshemeve.

Zbukurimet e dyshemeve nuk duhet te jene te ndërlikuara te shmangen tapetet me push te thelle.

Dyshemetë e mbaruara nuk duhet te jene te rrëshqitshme sidomos ne pjesët e hyrjeve.

Te shmangen ndryshimet e paparashikueshme te menjëhershme te nivelit.

Te sinjalizohen me drita, ngjyra ose strukture te ndryshme, ne nivele, tavanet e ulëta.

Te shmangen thyerjet ne mure, vendosje radiatorësh e pajisjesh ne korridore kur është e mundur .

## **VI.SIMBOLET URBANISTIKE**

Për te lehtësuar leximin dhe kuptimin e studimeve urbanistike përdoren:

1. simbolet qe janë kompleksi i shenjave me te cilat paraqiten ndërtimet, kufijtë fizike, qendrat e banuara, rrugët, kanalet etj;
- 2.kuotat;
- 3.legjenda;
- 4.zonifikimi.

### **1.SIMBOLET**

Simbolet brenda rrethit tregojnë prone private.

Simbolet brenda katrorit tregojnë prone publike.

Simbolet brenda trekëndëshit tregojnë prone ushtarake.

### **OBJEKTE TE ARSIMIT E KULTURES:**

Kopsht

Shkolle 8 vjeçare

Shkolle e mesme

Shkolle e mesme profesionale

Universitet

Biblioteke

Muze

Arkeologji

Teatër

Kinema

### **B.OBJEKTE TE KULTIT:**

Kishe  
Xhami  
Institucion fetar  
Manastir

c. V ARREZA:  
Varreze

#### D. OBJEKTE TE SHPLODHJES:

Lodra për fëmije  
Park argëtimi  
Pike çlodhjeje  
Kopsht zoologjik

d. Ngjyrat:  
per zone te gjelbert ngjyre jeshile e erret  
per zone banimi ngjyre e kuqe  
per objekt shoqeror ngjyre blu e erret  
per zone industriale ngjyre lejla ose oker e erret